

DHIMITER XHUVANI

BIBLIOTEKA

814-32

24 97

GRUAJA
LAKURIQ

Onufri

novelë

84-32

2497

DHIMITER XHUVANI

Gruaja lakuriq

NOVELE



SHTEPJA BOTUESE ONUFRI

Redaktore: FLUTURA AÇKA

Piktor : HYQMET XHANI

Në klubin e vogël, që shërben dhe si restorant për ata pak punëtorë të mbetur pas inaugurimit të hidrocentralit të Shkopetit, si edhe për pasagjerët, që udhëtojnë në Veri, ishte ulur që prej më se dy orësh një burrë. Ai, herë pas here, shkëpuste sytë nga libri dhe vështronte nëpërmjet rretës prej teli, peisazhin e Shkopetit. Rrjeta e telit, e vendosur qysh para pesë vjetësh, kur kishin filluar punimet, ishte ndryshkur e ishte mbushur me pluhur aq, sa edhe sikur përjashta të ishte dita më e pastër dhe më e shkëlqyer, do të dukej e vrenjtur, e zymtë dhe e trishtuar, gati për të rënë shi.

-Më sill dhe një raki - tha burri duke u kthyer nga banaku.

-Si urdhëron, shoku gazetar, -u përgjigj bufetieri që shërbente dhe si kamarier. - Juve jeni i pari gazetar që keni qëndruar më shumë se cilido nga kolegët tuaj. Unë jam një nga të parët që kam ardhur këtu në Shkopet. Besoj se do të jeni mërzitur ?

-Sot u mërzita, - pohoi gazetari.

-Sigurisht, tashti këtu çdo gjë mori fund. Të gjithë u larguan.

-Po juve pse s'ikni ?

-E ku të vete ?

-Po, këtu s'besoj të kesh më xhiro !

Bufetieri qeshi.

-Ka, dhe do të ketë. Ngado që të shkojnë makinat, këtu do të marrin frymë. Rruga e keqe të lodh. Një gotë birrë ose raki këtu vlen më shumë se në Tiranë. Pastaj, - po bufetieri s'e mbaroi fjalën, u vrenjt në fytyrë dhe zgjati kokën në derën e hapur. Dhe gazetari vështroi përjashta, e pa se si frenoi një autobus i vogël, duke ngritur nga pas, deri tek ngarkesa e autobusit që ishte mbushur me dekorët e ndonjë pjese teatrale, një re të tërë pluhuri.

-Do të jetë ndonjë grup artistik, - pëshpëriti bufetieri dhe zuri vend në banak duke rregulluar gotat e shiset e shpërndara.

Nga autobusi filluan të zbresin pasagjerë, të cilët vështronin rreth e qark, si gjithë ata që zbresin për të parën herë në një vend të

panjohur, aq më tepër, në një hidrocentral, për të cilin pesë vjet me radhë kishin shkruar gazetat.

Gazetari pa të zbresë nga autobusi një siluetë femre. Vetëm tashti ai vuri re se rrjeta prej teli ishte e ndryshkur dhe tërë pluhur aq, sa të pengonte pamjen, megjithatë format e bukura të trupit depërtuan rrjetën e vjetër.

Pasagjerët hynë plot potere në restorantin e vogël, si të ishin punëtorë që sapo mbaruan turnin e drekës. Gazetari u bë kureshtar të verifikonte atë siluetë me dy ngjyra. Ç'ishte vallë ?

-Pa shiko, - thirri një nga artistët, këtu qenka "Shpendi shtegtar" dhe, duke hapur krahët, u sul drejt gazetarit, të cilit s'i erdhi mirë që shoku i tij e quajti "shpend".

Te dera atë çast bëri ballë edhe silueta. Ishte vërtet një vajzë. Tani, që nuk e pengonte më rrjeta e telit, gazetari pa format e bukura të atij trupi të rrallë, që kishte diçka të veçantë.

-Të prezantoj... - foli artisti duke iu drejtuar vajzës, e cila u afrua. -Ky është autori i reportazheve interesante dhe i disa tregimeve. Besoj se do ta kesh dëgjuar. Radioja nuk le gjë pa transmetuar nga shkrimet e tij, e quajnë Josif Komini, ndërsa kjo, - iu drejtua gazetarit, - është... si t'jua them, është... - dhe, duke mos gjetur dot fjalën, mori një pozë si në skenë dhe iu drejtua asaj : - ja, që nuk e gjej dot se ç'je ti për ne !

Ajo qeshi me të madhe, me zë të lartë, të pastër e duke qeshur mundi të thotë :

-Unë jam Lukrecia. E keni parë komedinë "11 Qershori" të Holbergut?

-Jo, - u përgjigj gazetari.

-Si?- u habit vajza, sytë e së cilës u vrenjtën mjeshtërisht.

-Jo, - u përgjigj përsëri gazetari, si i zënë në faj.

-Hajdeni me ne në Burrel dhe do ta shikoni se kush jam, - tha dhe u ul duke përplasur duart që të dëgjonte kamarieri.

-Si ju quajnë ? - pyeti gazetari.

-Gjersa të mbarojë turneu ynë, më quajnë Lukrecia, pastaj, pastaj emri im s'ka rëndësi, ne jemi artistë vetëm për disa javë në vit, vetëm disa javë në vit unë jam ajo që dëshiroj të jem, pastaj... o, po unë budallaçka, pse po rrëfhem kështu ?

Josifi nuk po e dëgjonte më. Vështrimi i tij ishte mbërthyer në fytyrën e Lukrecias. Ai përpiquej ta kujtonte në se e kish parë ndonjëherë këtë femër, apo jo ?

-Si vendosët ? - pyeti ajo pas pak.

-Nuk di si t'ia bëj. Kohë të lirë kam, këtu zëre se mbarova, - foli gazetari.

-Hajdeni, - iu lut shoku që e kishte quajtur shpend shtegtar, -së paku deri në Burrel, sa të shikoni komedinë tonë, mbase shkruani pak rreshta edhe për ne endacakët.

Lukrecia u ngrit në këmbë të paguante në banak. Pagoi dhe pangatavolina ku ishte shoku i saj, Shkëlzeni me gazetarin. Megjithëse ata po bisedonin, sytë e gazetarit ndoqën vajzën. Ai kishte dëshirë ta shikonte dhe njëherë atë përtej telit të ndryshkur.

Që nga rruga e dëgjua boria e autobuzit të vogël. Lukrecia ktheu edhe një herë kokën. Ata vazhdonin të bisedonin. Ajo ngriti dorën dhe e përshëndeti gazetarin kot. Përtej telit, ajo nuk dukej veç një siluetë.

Boria e autobusit u dëgjua përsëri.

Lukrecia hipi në makinë.

-Të gjithë jemi ? - pyeti regjisori.

Nga klubi doli Shkëlzeni dhe Josifi.

-Po ai, kush është ? - pyeti regjisori.

-Është një gazetar, - foli dikush, - duket, do të vijë me ne.

Lukrecia ndjeu vështrimin e regjisorit. Pa dashur ajo mblodhi supet si për t'u shfajësuar. Ajo e dinte që regjisori tashti do të thosh frazën e tij të preferuar : "Sa mirë , që në kohën e Shekspirit luanin

do ta sillte rasti që ta shikonte dhe një herë këtë vajzë të çuditshme, që luante aq bukur me të gjithë, e me sa dukej, kishte një dëshirë të pafund vetëm për të luajtur.

Dikush mori rutinë e shahut dhe u sul pas saj.

-Shah! - thirri Josifi i gëzuar.

Njëri, që i rrinte mbi kokë Josifit, i tha :

-Në se të pëlqen më shumë shahu, liromë vendin.

Josifi u ngrit, si i çliruar nga një ankth dhe doli përjashta, i ndjellur nga loja e Lukrecias.

Makina lëshonte avull. Asfalti i rrugës, i shkrirë nga vapa, dukej sikur avullonte. Dhe bari i kodrave ish tharë dhe ish zverdhur.

Nën hijen e një dushku, Lukrecia dhe ai që e ndoqi pas, ishin kërrusur mbi rutinë e shahut. Ai qëndronte i mbështetur në dy bërrylet dhe priste tërë fodullëk që ajo të shpëtonte nga situata e vështirë, ku ai e kish vënë me një lëvizje të kalit.

Josifi u afrua ngadalë. Ajo ngriti kokën dhe e vështroi :
"Shpëtomë!", - thoshin sytë e saj. Josifi u hutua. Ndihej që i kërkoi ajo

me sy sikur s'kishte të bënte aq me lojën e shahut, me rrezikun e humbjes. Në sytë e saj kish një brengë, një ankth, një torturë të vërtetë, që e kishte çoroditur aq keq sa nuk e priste gjë tjetër veç vdekjes.

Josifi u tremb. Lukrecia e pa tronditjen e gazetarit dhe iu dhimbs. Buza i qeshi. Ajo, sepse e ndjeu të nevojshme dhe, si për ta shpëtuar, i pëshpëriti :

-E di lojën e shahut, apo jo ?

-Si s'e di ?

-Fol pra, se ky nuk dëgjon mirë nga veshët, - shtoi me një seriozitet të tillë, që Josifi e besoi dhe, duke ulur zërin, pëshpëriti :

-Dil me oficerin e zi tre kuti përpara.

-Po të dal atje, më ha me gur, - u përgjigj Lukrecia me zë të dobët, si me të qarë, gjithnjë duke pëshpëritur si suflerët.

-S'ka gjë, le ta hajë, fitore pa sakrificë s'ka, - tha Josifi.
Lukrecia lëvizi oficerin e zi. Kundërshtari tërhoqi kalin.

-Pse s'e hëngre? - pyeti Lukrecia.

Boria e makinës u dëgjua përsëri. Dikush, nxorri nga dritarja e autobusit një këmishë dhe e tundi si flamur.

Makina u nis ngadalë. Të tre ata mezi hypën, duke u rrezikuar. Lukrecia i shfryu tërë inat shoferit. Ai qeshte me të madhe, duke imituar zërin e saj.

Mbi valixhen loja vazhdoi e gjallë dhe e egër. Bixhosçinjtë ishin bërë nevrinë dhe vështronin vjedhurazi njëri - tjetrin.

Josifi ishte ulur prapa Lukrecias dhe gjatë gjithë rrugës, pa aq shumë qafën e hollë dhe të bukur të artistes, sa u mërzi.

"-Po kjo, pse më ftoi, për të më treguar se ka qafë të bukur?" - pyeti veten Josifi.

Shkëlzeni, që kuptoi se shoku i tij mendonte diçka të mërzi, e pyeti se çfarë s'i pëlqente.

-Zhurma, - u përgjigj Josifi.

-Përkundrazi. Zhurma duhet të të pëlqejë. Zhurma për ne është suksesi. Në qoftë se do të vish me ne deri në fund të turneut dhe, nëqoftëse do të bëjmë një pjesë të rrugës në qetësi, dije, se punët s'janë mirë.

-Domethënë, zhurma është barometër për juve? - pyeti Josifi.

-Po, zhurma dhe Lukrecia. Tashti e gjeta, që s'munda ta them në klubin e Shkopetit; Lukrecia për ne është barometri, jo, jo, - tha pas pak, i penduar, - sikur nuk shkon, apo jo Lukrecia? - thirri Shkëlzeni.

-Çfarë? - pyeti ajo dhe rrotulloi qafën. Fytyra e saj shkëlqente.

-Jo, jo, s'e kam gjetur akoma. Thashë se ti je barometri i autobusit.

-Si s'ke turp, Shkëlzen, të më krahasosh me një pikë zhivë.

-Jo, pra, e tërthoqa.

Lukrecia u kthye përpara.

-Eshhtë ... - filloi përsëri Shkëlzeni, sikur ta gjente gjë a gjëzën.

Lukrecia përsëri u kthye e tëra dhe e mbërheu me sy Shkëlzenin.

- Thuaje! Hë, thuaje, ç'jam ?

- Gjithçka, - pëshpëriti Shkëlzeni.

Ajo u kthye përsëri përpara dhe u përzie me grupin tjetër. Ata ia dhanë të qeshurit.

-Po, -vazhdoi Shkëlzeni, - ajo është vërtetë gjithçka për ne. Unë, s'mund ta marr me mend grupin tonë teatral pa atë, jo vetëm në turne, po dhe në Tiranë, megjithse atje...

-Çfarë ? - pyeti Josifi.

Shkëlzeni nuk vazhdoi dot bisedën. Lukrecia ktheu kokën nga ata dhe e kërcënoi me gisht.

Shkëlzeni u skuq, kurse gazetari qeshi me xhestin e saj femënor.

-E qeshura me zë të lartë është monopoli im. Nuk lejoj asnjë të ma kalojë qoftë dhe një notë më lart, - e qortoi Lukrecia.

-Ashtu është, - pohoi Shkëlzeni.

Josifi ndjeu se në shakanë e Lukrecias kish diçka që nuk shkonte, që tingëlloi e trishtueshme. "Ç'është kjo vajzë?" - pyeti veten gazetari.

* * *

Që larg u duk Burreli. Regjisorin u ngrit në këmbë, ndërpreu lojën dhe, si vendosi me vështirësi qetësinë, bërtiti :

- Ata që kanë radhën do të rregullojnë skenën, të tjerët do të pushojnë pak në hotel.

Josifit i erdhi keq kur dëgjoi këtë urdhër. Nga çasti që Lukrecia e kërcënoi me gisht, ai mendoi se, kur të mbërrinin në qytet, do të mundte të bisedonte me të lirisht, të pinte ndonjë birrë ose kafe, duke shpresuar ta njihte sadopak si tip.

Autobusi ndaloi para kinemasë.

Një mori femijësh e rrethuan autobusin e vogël dhe vështronin të habitur. Shumë kureshtarë të tjerë kishin ndaluar në dy trotuarët e rrugës, të tjerë dilnin nga dyqanet, kafenetë dhe vështronin së largu.

Josifi zbriti nga autobusi pas Lukrecias. Në trotuar i mori valixhen, dhe herë pas here, e vështronte vjedhurazi, kurse kalimtarët e rastit, ose ata që kishin dalë prej dyqaneve, vështronin pa pikë ndrojtjeje e si të etur.

Lukrecia ndjeu sikur të ishte një pasanike e madhe, si ajo zonja e dramës së Dyrematit "Dama plakë", që kishte ardhur nga larg, nga Amerika e se valixhja, që mbante Josifi, ishte e mbushur me thesare. Një ndjenjë e tillë, atë e kishte përkëdhelur pothuajse çdo vit, kur dilte në turme, sigurisht në qytete të vegjël, në qyteza ose qendra industriale. Ndonëse e ndjente nuk kishte çarë kokën të kuptonte se ç'qe ajo ndjenjë e çuditshme. Pse shikohej ashtu nga banorët e qytezave. Çfarë shikonin ata te ajo? Cila ishte ajo e veçantë, që rrezatonte nga trupi i saj? Mos vallë këmbët e bukura? Apo trupi i saj tepër i brishtë? Ose beli i këputur dhe vithet pak të kërcyera, që kishin një lëvizje të veçantë? Mos vallë gjoksi pa reçipet, apo qafa prej mjelme dhe vështrimi si prej kaprolli? Në të vërtetë, Lukrecia ish një tip pak e veçantë që dhe në Tiranë, në bulevard ose në punë, ose në skenën e Pallatit të Kulturës Ali Kelmendi ndillte vështrime kureshtarësh. Lukrecia diçka dinte, ose më mirë të themi, ia kishin zbërthyer të tjerët, që e shpjegonin me seksin, duke thënë se ajo, edhe kur ecën rrezaton seks. Jo, njëmijë herë, jo? Lukrecia, si vajzë e zgjuar, i dallonte shumë mirë vështrimet epshore të burrave, ose ziliqare të grave. Jo. Nuk ishte kjo e veçantë që ajo shpërndante. Ishte

diçka tjetër, mund të kishte të bënte dhe me seksin, po jo e gjitha. Seksi mund të ishte në një përqindje aq të vogël, sa mund të quhej e pallogaritshme. Ajo, sidomos në qytetet e vegjël, duke u parë nga gjithë kalimtarët, pat qëlluar t'i afrohej zgjidhjes së enigmës, por jo përfundimisht.

Eshtë e pamundur, e pashpjegueshme që, një qytet i tërë, me djem të rinj, burra, pleq e plaka dhe fëmijë ta shikonin ashtu, ja, si tani, që ajo po ecte në të vetmen rrugë të Burrelit. Ajo ishte e lumtur edhe për një arsye tjetër. Ajo, në të tilla raste, komunikonte me njerëzit si me telekomandë. I lindte në shpirt e në mendje fare e qartë se, ata që po e shikonin, i shikonte dhe ajo dhe ndjente se ata kishin dëshirë që ajo të bënte diçka të veçantë, një xhest, një shikim, një lëvizje që në qytetin e tyre nuk guxonte të bënte as dhe një grua, apo vajzë çapkëne. Se ç'ishte ajo që duhej të bënte për ta, Lukrecia, nuk e dinte. Vetëm e ndjente si një detyrë që japin shpesh herë regjisorët, të cilët, as ata vetë, nuk e kanë të qartë se çfarë interpretimi kërkojnë. Nuk ishte as evidentimi i lëvizjeve të vitheve e të belit, siç bëjnë manekinët në paradat e modës, as lëkundjet e gjinjve joshës si çingitë turke. Jo. Para disa vitesh, në një qytet verior, kur po ndodhte e njëjta gjë, që po zhvillohej tani, ajo, Lukrecia, kishte pandehur se publiku i rrugës atë priste, evidentimin e seksit. Dhe ajo e kishte bërë, sigurisht me shumë shije, po dikush e fërshëlleu. Lukrecias i ngriu gjaku në deje. U turpërua si asnjëherë tjetër në jetën e saj. Dhe, që atëhere, ajo u bind se njerëzit diçka tjetër shikonin te ajo, po se çfarë ajo nuk e pat gjetur plotësisht. Me intuitën e saj, te e cila ajo bazohej shumë, kishte pranuar si shkak të atyre vështrimeve një gjë të largët, një mendim, që asaj i pëlqente të ishte e vërtetë. Ajo që ndjente Lukrecia dhe që ajo vetë ishte në gjëndje ta sqaronte ishte diçka e vogël, por e rëndësishme, të qënurit e lirë. Dhe këtë gjë, më shumë se çdo gjë nga pjesët e trupit të saj, e ndjente qafa dhe këmbët. Këmbët ecnin më lirshëm dhe qafa sikur ndjente se frynte një fllad,

në atë pisk vape e zagushie dhe se, thellë-thellë vetes së saj, i dukej sikur ishtenë skenë e jonë rrugë ese, në atë mënyrë të ecuri, ajo duhej të shprehte diçka të turbullt, por që ia pëlqente shpirti.

-Unë i urrej banorët e qyteteve të vogla, - foli Josifi.

Lukrecia ktheu kokën e habitur nga ç'dëgjoi. Josifi u mat të justifikohet, po ajo foli më parë :

-Ndërsa unë i dua. Janë më të sigurtë se disa të veshur spic, që sillen bulevardit të Tiranës.

-Shiko si të vështrojnë! - tha Josifi.

-E ç'të keq ka këtu ?

-Ajo është mungesë kulture.

-Unë do të thoshja se është thjeshtë kuriozitet. Vjen një grup artistik dhe ata sodisin. Këtu pothuajse të gjithë banorët njihen me njëri-tjetrin, ndërsa ne, për ta jemi fytyra të reja.

-Shoko ! - foli një nga banorët.

Josifi ktheu kokën me mospërfillje.

-Kaluat hotelin, - tha ai dhe qeshi.

Josifi u skuq dhe u kthye.

E gjithë trupa, zunë një krah të tërë të korridorit, që kishte dhjetë dhoma. Regjisori, që atë çast të kujtonte një kapter, filloi të bërtasë :

-Veç atyre, që janë caktuar për rregullimin e skenës, asnjë të mos dalë nga hoteli. Shfaqja do të fillojë shpejt, ndaj dua që të shplodheni.

Lukrecia falenderoi Josifin, që i mbajti valixhen dhe hyri në dhomën e saj.

Josifi ndejti më se gjysmë ore shtrirë në shtrat dhe u ngrit i nevrikosur që s'e zuri gjumi. U vesh dhe doli përjashta.

Në rrugë , i ra përnjëherësh në sy reklama e pjesës që do të luhej atë natë dhe turma e madhe e grumbulluar pranë saj. Josifi u afrua që të lexonte emrin e artistes që do interpretonte Lukrecian.

Më në fund, arriti përballë reklamës dhe lexoi:

Lukrecia - interpretor, Zoica Braho.

"Kështu pra, të quajtkan, Zoicë? - foli me vete Josifi. "Emrin e paske të bukur, kurse mbiemrin..." Josifi mblodhi buzët dhe u nis drejt kafenesë.

Duke e pirë kafënë ngadalë e si me përtesë, vështronte banorët e qytetit. Si gazetar, e dinte mirë se atë ditë qyteti kish një dritë tjetër, si të gëzuar, që ishte ngjallur nga reklamata në qoshe të rrugës dhe autobusi përballë kinemasë. Mëqë e njihnte mirë jetën e qyteteve të vegjël, të ngjashëm shumë njëri me tjetrin, ishte në gjendje të vinte re se ç'që zgjuar atë ditë.

-Më falni, o shok, - i foli Josifit një burrë i thyer në moshë dhe i mbështetur mbi një bastun të trashë.

-Ç'është? - pyeti Josifi dhe ndjeu një ftohtësi e drithmë në shpirt kur pa burrin me një këmbë prej druri.

-Kur ndaloi autobusi ju vura re që zbritët nga makina, që shoqëruat atë shoqen e bukur, tamam si i ka hije një njeriu, një artisti me një fjalë.

-Unë s'jam artist, - tha Josifi.

-E, atëhere jeni njeri me kulturë, besoj se do të më bëni një të mirë.

-Urdhëroni!

-Pas pak kohë do të fillojnë të shiten biletat, ja po grumbullohen.

Josifi pa një grup njerëzish, që ecnin me të shpejtë, me në krye llogaritarin e trupës teatrale me atë çantën e tij të vjetër e të lidhur me spango, i cili, nga vrulli i turmës që e pasonte, shpejtonte dhe ai. Kur llogaritari u fut në sportelin e kinemasë, turma që kish marrë vrull, u përplas e tëra pas murit të sportelit.

Josifi u kthye nga njeriu që i foli me aq përzemërsi:

-Unë s'mund të afrohem atje, - vazhdoi burri me bastun, -

bile, edhe ata s'kanë për të marrë bileta. Ato shiten me autorizim. Kinemaja është e vogël, njerëzit që marrin me autorizim janë të shumtë. Ju lutem, më merrni një biletë.

-Mirë, - tha Josifi, - para se të fillojë shfaqja më prisni përjashta.

Në dyshemenë prej dërrase të kafenesë u dëgjua goditja e bastunit metalik. Burri ecte duke bërë një hap të madh, të hapur e të gëzuar.

* * *

Ngadalë ra mbrëmja. Përpara kinemasë ishin grumbulluar burra, gra e fëmijë, të veshur si për ditë feste. Gratë rrinin pak të veçuara nga burrat, grupe- grupe në formë rrethi dhe bisedonin. Fëmijët luanin luftash, duke përdorur prindërit si gurë kufiri.

Që larg u dëgjuan disa hapa të rëndë, që rrihnin me komandë asfaltin e rrugës. Dhjetë policë të rreshtuar qëndruan para kinemasë, duke marrë drejtqëndrim. Kapteri, që i komandonte, dha urdhër për njëshkollonë dhe, po duke rrahur trotuarin me çizmet e tyre tërë gozhdë, hynë në kinema.

Josifi, që i vështronte të gjitha këto nga dritarja e kafenesë përballë, pa orën që ishte 8 pa 10 minuta dhe u ngrit. Sapo doli në trotuar, pa Lukrecian.

"Po kjo, mendoj Josifi, pse po shkoka kaq vonë në skenë?"

Turma, sapo afrohej ajo, hapte rrugë. Lukrecia ecte ngadalë, duke ndierë vështrimet e njerzve. Ecte ngadalë e në mënyrë provokuese. Disa të rinj filluan të pëshpërisin e të thumbojnë :

-Kjo është ajo artistja, - tha një djalë me një kasketë të vjetër, të kthyer mënjanë.

-Duket që në të ecur, - iu përgjigj shoku.

-Ecën ashtu për të treguar vithet.

-E njoh unë atë, që kur kam qenë ushtar në Tiranë - tha përsëri i pari.

-Dhe vijnë këtu e shesin mend.

-Eshtë e mirë, ama, - tha një tjetër.

Josifi u nxeh dhe u afrua. Ata u vështruan e heshtën. Dikush pëshpëriti aq sa e dëgjoji Josifi :

- Ky është ai që i mbajti valixhen.

-E çdo të thuash me këtë ? - shfryu Josifi.

-Sigurisht, që do të keni ndonjë biletë? - pyeti tjetri.

-Kam, po jo për ty, - i tha Josifi dhe dallooi midis turmës burrin me bastun.

Ai vinte vërdallë dhe shikonte si i hutuar. Josifi ngriti dorën lart dhe ia bëri me shenjë.

-Urdhëroni, është në radhën e dytë.

- Ama, paska gjetur se kujt t'ia japë biletën, - qeshën të rinjtë.

- Josifi bëri sikur nuk dëgjoji, për të mos ofenduar burrin me këmbën e drunjte. "Sigurisht, po të kishin gjetur biletë, s'do të flisnin ashtu", - mendoi Josifi dhe hyri në kinema.

Salla ishte e vogël, dyqind vendëshe, po zhurma ishte e madhe. Në dy krahë të sallës, që kish nga pesë dritare, Josifi pa një polic në secilën.

-Po këta ? - pyeti Josifi burrin që i dha biletën.

-Ruajnë dritaret.

-Pse ?

-Sapo të shuhen dritat është rrezik të sulmojnë ata.

-Kush ?

-Ata , që janë përjashta.

-Të sulmojnë ? - pyeti përsëri Josifi.

-E pse jo. Të parët do të jenë ata të rinjtë.

-Unë po zresha, mos të kishe ardhur ti, do të isha rrahur.

-Pse ?

-Sepse kërkojnë kulturë në një mënyrë të pakulturuar.

Burri sa s'shtangu kur dëgjoji Josifin.

Në çast , në sallë , filluan të përplasin duart. Josifi pa orën.
Kishin kaluar disa minuta.

-Tashti do të fillojnë , - foli Josifi në shumë më vete, se sa me shokun që kish për krah, duke ndjerë një emocion të pakuptuar.

-S'besoj. Tek ne as filmi nuk fillon fiks , e jo një shfaqje teatrale, që është një gjë e rrallë.

Përrjashta zërat filluan të shtohen, ata e ndienin më shumë se sa të brendshmit hapjen e siparit.

-Mos u çuditni , - foli përsëri burri me këmbë prej druri. Përrjashta janë më shumë se sa ne këtu, do të bëni mirë sikur të rrii edhe nesër mbrëma. Burreli s'është më qytet i vogël, sa ka qenë dikur.

-Do t'u them të rrinë edhe nesër.

-Do bëni shumë mirë.

Pas pak policët zunë vend nëpër dritare.

-Tashti do të fillojë , - tha burri.

Josifi vuri re se dritaret ishin të ngushta, aq sa, ai, që do të guxonte të sulmonte, do të shtynte policin.

Ngadalë u shuan dritat. Përrjashta turma e ndieu dhe filloi të lëvizë e të zhurmtojë e shqetësuar. Perdja u hap e tëra dhe salla u ndriçua nga dritat e skenës, me një dritë të ftohtë e të zbardhët, që të kujtonte vendet skandinave. Skena ishte pak e ngarkuar. Piktori dukej se që munduar shumë, që të jepte me hollësi tablonë e Kopenhagenit.

Në sallë u ndie një lëvizje e përgjithshme. Josifi nuk e kuptoi shkakun.

Ai priste me ankth të madh të dilte dukësia. Në vend të saj dolën dy zotërinj të veshur si qëmoti, si në shekullin XVIII, bile dhe

me shpatë. Njëri prej tyre ishte shumë i shqetësuar. Ai kish marrë vesh se në qytetin e tyre do të vijë një koprac për të mbledhur borxhet me kamatën përkatëse.

"Do ta vras", u dëgjua zëri i zotërisë që kumboi në sallë, aq sa vuri edhe qetësi.

Shoqëruesi i zotërisë, që siç dukej, do të ish një shërbëtor dinak, i pëshpëriti diçka në vesh. Zotëria, tepër i kënaqur, qeshi me të madhe, si për zili të atyre që ishin jashtë mureve të kinemasë.

Kështu filloi të përgatitej një kurth për fajdexhiun, që do të mbliidhte pare, një kurth që do zgjaste dy orë megjithë tre pushimet nga dhjetë minuta. Në kurth u përzie edhe Lukrecia, e cila, herë pas here qeshte me të madhe. Josifi, nuk u emocionua kur e pa Lukrecian të veshur si gruaja e hotelxhiut, as në fund fare nuk u emocionua, kur të gjithë kishin triumfuar mbi kopracin, duke e detyruar të largohej nga qyteti si pulë e lagur.

Ngadalë perdja filloi të mbyllej. Burri me këmbë prej druri, kish mbetur pak si i hutuar, i ndrojtur dhe shikonte me frikë nga gazetari, se mos vallë, ai e pyeste për shfaqjen.

Perdja u mbyll fare. Asnjë e çarë, asnjë rreze drite s'depërtonte më nga skena, sikur ajo të kish pushuar përgjithnjë së qeni një botë më vete, larg, deri në Kopenhagë.

Populli ish larguar i tëri. Josifi kish mbetur vetëm në sallën e madhe. Pas perdes u dëgjuan zëra. Ai dalloi zërin e Lukrecias, por e mbyti zëri i regjisorit. Pastaj u dëgjua përsëri zëri i saj.

"Po ziren", mendoi Josifi dhe hipi në skenë.

Të gjithë ishin grumbulluar rreth regjisorit. Të gjithë ishin nevrinë, gjysma të veshur si në shekullin XVIII gjysma si në shekullin e XX.

-Pse shfaqje është kjo? - thirri tërë inat Lukrecia.

-Po ç'është? - i shfryu regjisorit.

-Derisa s'pëlqehet nga publiku nuk është shfaqje, - tha

Lukrecia dhe u skuq kur pa Josifin.

Të gjithë heshtën, ndërsa ajo, e veshur siç ishte në skenën e fundit, me një këmishë nate të hollë, ngjyrë trëndafili, mblodhi duart para gjoksit dhe u tkurr si e zënë në befasi, ashtu gjysmë lakuriq. Të gjithëve u bëri përshtypje turpi dhe ndrojtja prej gruaje e Lukrecias, e cila, gjatë shfaqjes, duke luajtur shërbyesen e hotelit, sidomos në skenën e fundit, e veshur me atë këmishë të hollë nate, që harruar aq shumë pas lojës sa nuk kishte vënë re fare as gjinjtë, as gjunjët, as belin, që lodronin në këmishë, rolin e gruas pa cipë.

Regjisori pa me habi gazetarin, ndërsa Shkëlzeni sepse e ndjeu veten fajtor dhe shkaktar të këtij gjesti turpi e ndrojtje të shoqes së tij të ngushtë, dhe i erdhi çudi. Ai s'kishte vënë re të ndodhte ndonjë gjë e veçantë midis Zoicës dhe Josifit.

-Më falni, - tha Josifi, i cili sepse e ndjeu veten të huaj aty në skenë, pas perdes së mbyllur, të huaj e të tepërt për atë intimitet midis artistëve. Ajo skenë, ajo dhomë hoteli i Kopenhagës dhe ajo aktore, shërbyese e atij hoteli, gjithë ata aktorë të veshur si në Kopenhagë dhe shoku i tij i ngushtë, Shkëlzeni, iu dukën si të një bote tjetër.

-Më falni, - tha sërish gazetari i mbetur si guak.

* * *

Kur tërë trupa doli nga kinemaja, qytetin e vogël e kish zënë gjumi. Asnjë njeri në rrugë, asnjë dritë në dritare.

-Dëgjoj muzikë, - thirri e gëzuar Lukrecia.

Të gjithë mbajtën vesh, si të ish diçka e rrallë të dëgjosh muzikë në mes të qetësisë së natës në një qytet të vogël që fle.

-Ju presin juve për të ngrënë, - tha përgjegjësi i kinemasë.

-Mrekulli, - thirri Lukrecia, - sa gjë e bukur është kur të pret për të ngrënë një qytet që fle.

-Ç'filozofoni kështu ? - pyeti regjisori. ^;

-Më vjen keq, më duket sikur nuk i kënaqëm burrelasit. Sa mirë do të ish sikur ata të kishin parë në skenë diçka të tyren, që të kishte lidhje me jetën e tyre, që kur të largoheshin e të shtriheshin në shtrat të mos flinin menjëherë.

-Ashtu është, - foli Josifi. - Çfarë mund të mendojë njeriu i sotëm, kur shikon në skenë se si Holbergu vë në lojë fajdexhinjtë e shekullit XVIII me anën e dinakërisë së një shërbyeseje, kur ndiehet nevoja e sa e sa problemeve të kohës sonë ?

-Bravo, - thirri Lukrecia e përplasi duart. Sytë e saj ndritën nga gëzimi.

Muzika tashti dëgjohej më e qartë dhe më e fuqishme. Megjithëse orkestra e vogël, e së vetmes lulishte, s'luante mirë, ajo të prekte. Mbase emocionin ia jepte muzikës nata, qetësia e qytetit që fle, kamarierët që presin dhe ato pesë a gjashtë tavolina me klientët kureshtarë.

Lulishtja ishte e vogël. Në mes-kish një pistë të rrumbullakët me lule anash. Pranë derës së kuzhinës ishte vendosur orkestra. Sapo hynë artistët, orkestrantët filluan t'i bien më me gjallëri.

Pranë tavolinës, ku u ul Lukrecia me regjisorin, Shkëlzenin dhe gazetarin, ishin edhe klientët kureshtarë. Në tavolinën e parë ishin tre femra, mes pesë meshkujve. Dhe më tutje, në gjysmerrësirën e lulishtes, ishte një çift që rrinte si i fshehur.

-Një kuriozitet, - nisi të flasë gazetari, - në këtë pistë s'ka kërcyer akoma asnjë çift, megjithëse po bëhen dy vjet që është ndërtuar. Qëllova këtu ato ditë për një reportazh mbi zakonet prapanike. I gjithë qyteti e priste atë natë si një eveniment me rëndësi. Vendosa dhe qëndrova. U nisa të nesërmen tepër i mërzhitur. Biles, me këtë fakt e mbylla reportazhin se si njerëzit, të mobilizuar luftonin zakonet e vjetra, po nuk guxonin të gëzonin, ose të krijonin zakone të reja, domethënë ta inauguronin lulishten duke kërcyer. Përgatitjet genë bërë të mëdha. Qe zbukuruar dhe me drita shumëngjyrëshe, që

shuheshin e ndizeshin. Kuzhina? Ç'të të them, gjithë të mirat. Dhe fjalimi u mbajt atë natë nga vetë sekretari i parë i rrethit dhe nga kryetarja e gruas, po kurkush nuk u ngrit për të kërcyer. Duartrokitën, hëngrën, pinë dhe ikën. Kur vajta në hotel, s'më zinte gjumi. Rrija në dritare dhe shikoja dritat e lulishtes, që vazhdonin të shuheshin e të ndizeshin, si të ishte një far i braktisur ku s'kish për t'u afruar asnjë anije.

Lukrecia hapi sytë. Në to shprehej një habi e një hutim. Pas pak, ajo buzëqeshi, buzëqeshi ngadalë e hidhur, duke vështruar tre gratë në tavolinën fqinjë.

-Ngreu, - i tha ajo gazetarit, - ngreu. Unë do ta inauguroj sonte pistën.

Josifi qeshi dhe e vështroi Lukrecian drejt e në sy. Ai pa dashur e parafytyroi me këmishën e hollë e të tejdukshme ngjyrë trëndafili.

-Jo, jo, më fal, - i foli Josifit, Lukrecia, - meqë në këtë pistë do kërcëhet për herë të parë, dhe kërcimi ynë do të jetë një mësim, dua të kërcëj me regjisorin.

-Nuk jemi në skenë këtu, - foli me inat regjisorin.

-Të mendojmë sikur jemi në skenë. Këtu s'është kërcyer asnjë herë, megjithëse njerëzit dinë të kërcëjnë e duan të kërcëjnë.

Regjisorin u ngrit ngadalë, i mori dorën Lukrecias dhe të dy filluan të kërcëjnë. Muzikantët, sa s'fluturuan nga gëzimi, ata filluan t'i bien si të çmendur.

Të gjithë sa ishin në lulishte, u kthyen nga pista dhe vështronin çiftin që danconte.

-Ti je shumë e mirë, Lukrecia, - i pëshpëriti regjisorin.

-Më erdhi keq për ato tri gratë dhe për atë çift që rri si i fshehur nën hijen e pemëve.

-Ti mendon se ato do të ngrihen të kërcëjnë tashti ?

-Në qoftë se do t'u vijë zor sonte, nesër mbrëma do ta kenë

më lehtë. Unë i njoh gratë. Neve na mungon guximi.

* * *

Të nesërmen në mëngjes, kur po ngarkoheshin skenat, që paraqisnin sheshin e bashkisë së Kopenhagenit, përsëri u mblodhën kureshtarë. Më në fund, autobuzi i vogël e i vjetër u nis dhe njerëzit, çkeshin dalë për t'i përcjellë artistët, ngritën duart dhe i përshëndetën.

Lukrecia ishte mbështetur pranë dritares dhe vështronte tutje vargun e gjatë të maleve dhe këtë e bënte sepse prania e Josifit, që ish ulur pranë saj, e shqetësonte. I dukej sikur akoma kish rreth belit dorën e tij, që e shtrëngonte, i dukej sikur akoma, ndonëse kish kaluar një natë e tërë, vazhdonte të kërcente ngjitur me të në pistën e vogël dhe akoma i vinte inat që ai nuk e kish kuptuar mbrëmë. Ajo kishte qenë shumë e lodhur dhe megjithatë kish kërcyer, pothuajse me të gjithë shokët e trupës dhe këtë e kish bërë, jo pse kish patur qejf të kërcente, po pse besonte që, nga çasti në çast, do të ngriheshin ato tri gratë, që rinin dhe e vështronin pa i hequr sytë asnjë çast, ose ai çifti i fshehur në errësirë. Dhe ato ishin ngritur. Ishin ngritur të trija menjëherë. Lukrecia ia kishte arritur qëllimit, filloi të kërcëjë me gjithë shpirt, duke e lënë trupin të lirë dhe dora e gazetarit rreth belit të Lukrecias ndjeu se si u çkontraktuan muskujt, ndjeu se ai bel i këputur ishte një kulpër dhe ai mund të bënte me të ç'të donte, ta përkëdhelte, ta përdridhte. Atij i shkoi ndërmend se po të donte edhe mund ta këpuste. E gjithë Lukrecia tani ishte në dorën e tij. E tërhoqi pak fare, fare pak dhe u elektrizua kur ndjeu gjithë trupin e saj të pështetëj pas trupit të tij. Kofshët e saj të drejta e të gjata, sikur u deformuan, u bënë kulpra pas këmbëve të tij dhe gjinjtë, si dy dallëndyshe të trembura, u drodhën ngjitur pas gjoksit të tij. Nga përpëlajtjet e tyre Josifit iu duk se i mbinë në shpirt krahë e ai atë çast besoi se po të donte mund të fluturonte. Një afsh i ngrohtë i pështolli

të dy e sikur i veshi me një tis mjergulle të kaltër, si ajo e luginave, që fshehin për një çast pemët, gurët e lumit dhe vetë lumin. Të dy harruan se ku ishin, harruan se mjergulla kishte rënë në luginë e jo në pistë. Lukrecia, me sytë gjysëm të mbyllur, ndjeu se si i lëvizi qafa, si u përkul dhe, nga që nuk e mbante dot kokën, e pështeti në supin e Josifit.

Josifit iu duk si ëndërr. Si ndodhi kjo mrekulli? Ajo femër, aq enigmatike, aq e brishtë dhe aq e gjallë ra në krahët e tij? Tanimë Lukrecia nuk ishte një siluetë. Gjithë format e trupit të saj joshës ishin bërë njësh me trupin e tij. Veçse një trup i veshur që e ndante nga këmisha e tij fustani i saj, dy basme të thjeshta që për një çast të vetëm e fatal për të, iu dukën si parzmore të hekurta. Një etje e paduruar i lindi në shpirt e në trup Josifit. Ai ishte gati në prag të lumturisë së tij aq të mrekullueshme të asaj nate me yje, hënë e muzike, sikur në mos buzët, së paku lëkura e faqes së tij të prekte sado pak lëkurën e saj, të qafës ose të faqes, që ishte pështetur në gjoksin e në supin e tij. A do të ishte aq i guximshëm sa të bënte atë hap, që e ndante nga faqja e saj? A nuk do të ishte ajo puthje faqesh, ashtu gjoja si pa dashje, prelud i një nate çuditërisht të lumtur? Kush do e pengonte një hap të tillë? Cila forcë mund të frenonte atë pasion? Mos vallë vështrimi i kureshtarëve? Në atë pistë, që po kërcehej për herë të parë, mos vallë do të ishte gabim i pafalshëm që, qysh në shfaqjen e parë publike, të arrihej kulmi?

Mendimet e ftohën Josifin. Ftohtësia e tij u bë akull në trupin e Lukrecias, e cila u drodh dhe ngriti kokën. Sytë e saj u ndeshën me sytë e grave që kërcenin pranë saj. Sytë e tyre ishin të zgurdulluar. Lukrecia e njihte shumë mirë atë vështrim. E kishte parë kushedi sa herë gjatë shfaqjes së skenës së dhomës së gjumit, kur bënte sikur zbërthente këmishën e natës për t'i treguar fajdexhiut gjoksin e saj. E pa dhe sonte kur erdhi ai çast i puthjes por, ajo që po shikonte tani, te ato tri vajza e te ata pesë djem apo burra, e stepi.

Lukrecia ndjeu t'i skuqen faqet, t'i merren mendtë, aq sa iu duk sikur tavolinat dhe dritat e pistës po rrotulloheshin. Ajo u shkëput nga Josifi, po dorën nuk ia lëshoi.

- Të lutem, më ço të ulem. Më merren mendtë...

Makina mori një kthesë të fortë dhe Lukrecia, që vazhdonte të ndiqte me sy vargun e maleve, iu morën përsëri mendtë. Asaj i vinte zor të kthente sytë nga Josifi, i vinte zor, dhe turp dhe inat, sepse i dukej sikur akoma ndjente krahun e tij në belin e saj, i dukej sikur ndiente vështrimin e hutuar të tri shoqeve të panjohura.

Vargu i maleve mbaroi. Lukrecia mundi të përmbledhë veten dhe mori frymë lirisht. Ngadalë u kthye nga Josifi dhe i buzëqeshi. Josifi e kuptoi që buzëqeshja e saj ishte e thatë dhe e kotë, më tepër ishte një buzëqeshje për edukatë se sa e ndierë. Ai, gjatë gjithë asaj cope rruge, që ajo ndiqte me sy vargun e gjatë të maleve, kish kujtuar gjithë, po atë që e shqetësonte Lukrecian dhe kish gjetur arsyen e shqetësimit të saj dhe, kjo gjë e kish ftohur aq, sa ish penduar që kish vendosur të ndjekë trupën gjatë tumeut për në Veri. Nga çasti në çast, priste që ajo të kthente kokën e t'i kërkonte ndjesë për gjithçka, që kishte ndodhur natën e shkuar, por, kur më në fund ajo e ktheu kokën dhe i buzëqeshi, Josifi nuk mundi të thotë asnjë fjalë. Vuri edhe ai buzën në gaz dhe uli sytë.

Makina vazhdonte të ecte dhe heshtja, që kish hyrë midis tyre, filloi të bëhej shqetësuese.

-Vendose të vish më ne gjer në fund ? - prishi heshtjen Lukrecia.

-Po, - u përgjigj shkurt Josifi, duke parë Lukrecian në sy.

-Shumë mirë bëtë, mbase mund të shkruani ndonjë gjë nga ky udhëtim.

-Jo, s'kam ndërmend të shkruaj, - tha gazetari, - të të them të drejtën, as unë s'e di pse vendosa të bëj këtë udhëtim. Nuk e di, mbrëmë vendosa të kthehesha, kurse sot në mëngjes, m'u kthye

mendja dhe hipa përsëri në makinën tuaj.

-Mos u penduat ? - pyeti Lukrecia duke qeshur.

-Pak më parë se të flisnit isha gati të zbrisja, kurse tashti jo.

-Domethënë se qenkam unë ajo që ju tërhoqa, - tha

Lukrecia.

-Nuk e di, mbase, - foli Josifi dhe iu duk për një çast se Lukrecia kish të drejtë. "Ç'gjë tjetër mund të më ketë shtyrë ta bëj këtë rrugë të gjatë e të lodhshme, veçse kësaj ? - mendoi Josifi dhe uli kokën, duke ndierë në fytyrë vështrimin e saj të pastër e depërtues. Kur ngriti kokën ndeshi me sytë e saj. "Ç'sytë bukur!" - mendoi Josifi dhe e vështroi me kureshtje, si për të gjetur në sytë e saj diçka, që e kishte kërkuar prej kohësh.

Lukrecies i erdhi mirë që Josifi mbeti pak si i hutuar nga pyetja dhe, ndonëse s'mori përgjigje, e ndieuse kish qenë ajo që e kish tërhequr gjer në veri.

Këtë gjë e ndienë edhe gjithë ç'ishin në autobusin e vogël, i cili kish bërë më se njëzet kilometra. dhe akoma nuk ishte zgjuar, asnjëri nuk ia mori këngës, po gjithsecili, rrinte mbështetur dhe vështronte tej dritares.

Ngadalë heshtja filloi të rëndojë dhe mbi Lukrecian. Ajo i njihte mirë gjithë shokët e trupës dhe i erdhi çudi e turp që ata ranë në heshtje, sepse dikush guxoi dhe iu afrua asaj.

Makina vazhdonte të ecte. Dëgjohej vetëm zhurma e motorit. Pastaj regjisori mori valixhen, e ngriti, e vendosi si tavolinë dhe thirri shokët për të vazhduar lojën. Pas pak zhurma e makinës filloi të mos dëgjohej më aq e qartë dhe aq e mërzitshme. Dikush mori kitarën. Autobusi u gjallërua dhe filloi jetën e tij normale plot zhurmë e potere.

Lukrecia mori frymë lirisht, si e çliruar nga një barrë e rëndë. U ngrit e u afrua pranë atij, që i binte kitarës, po për të kënduar s'këndoi. Asaj i dukej sikur autobusi akoma s'ish zgjuar tamam. Pa

rënë në sy të të tjerëve, Lukrecia zgjati kokën dhe pa Josifin që kish kryqëzuar duart dhe vështronte tej dritares.

* * *

Lukrecias nuk i pritej që të arrinin sa më parë në ndonjë qytet të vogël, ose në ndonjë qendër industriale. Donte me çdo mënyrë që ë ndalonte autobusi.

-Dhe sa orë duhen gjer në Peshkopi? - pyeti ajo.

Josifit iu duk sikur s'ish zëri i saj.

-Jemi larg akoma, shumë larg, - filloi të flasë Josifi dhe, duke e vështruar në sy, pa se si ajo u ngrys.

-Pse qenka kaq larg kjo Peshkopia? - u ankua Lukrecia.

-Sepse, Shqipëria s'është aq e vogël, - tha me të qeshur Josifi.

Dhe ajo vuri buzën në gaz dhe ndieu se gjithë ai lëmsh i ftohtë që i rëndonte në gjoks sikur iu tret.

Makina u lëkund, siç duket nga ndonjë gropë e rrugës. Lukrecia u mbajt pas Josifit dhe qeshi me të madhe. Të gjithë, ndonëse të mësuar me qeshjen e saj të fortë e të pastër, kthyen kryet nga ajo. Asaj s'i erdhi mirë. Për të parën herë ndieu se e qeshura e saj s'u pëlqeu shokëve.

-Tashti iu afruam Bulqizës, - tha Josifi dhe vuri re se mbaroi asfalti i rrugës.

-Këtu s'kemi për të dhënë shfaqje, - shtoi Lukrecia.

-Pse?

-S'e kemi planifikuar.

Makina ngadalësoi shpejtësinë. Përnjëherësh, pas një kthese që bëri shoferi, doli para syve të të gjithëve, Bulqiza. Në të dy krahët e rrugës vinin me radhë, njëra pas tjetrës, ndërtesat dykatëshe. Dhe sipër tyre, në faqen e malit, nxinin grykat e galerive.

Makina ndaloi para klubit të minatorëve, buzë rrugës së vetme të qytetit gjithë pluhur.

-Dhjetë minuta pushim, - bërtiti shoferi dhe hapi derën.

Lukrecia zbriti e fundit dhe ngadalë filloi të ngjisë shkallët e klubit. Pranë banakut pa Josifin që po pinte. Ai ishte vetëm.

-Çfarë do të pish, kafe apo birra? - e pyeti Josifi dhe i bëri shenjë kamerierit që të merrte porosinë.

-Një kafe. - u përgjigj Lukrecia, duke iu afruar banakut.

Klubi zhurmonte si një koshere bletësh. Minatorët hynin e dilnin, duke folur me zë të lartë e kumbues. Shumë prej tyre që dilnin nga galeritë vinin drejt e në klub për të pastruar fytnin me ndonjë gotë Lukrecia shikonte dhe habitej. Dy minatorë, që sapo hynë në klub, iu afruan banakut. Të dy kishin në duar llambat e shuara të karbitit. Tjetri kish një çekiç me bisht të gjatë.

-Dy kafe, - tha njëri prej tyre.

Lukrecia i pa në fytyrë. Sytë, hunda, vetullat e të dyve ishin tërë pluhur. Megjithëse Lukrecia i shikonte shumë afër, asaj iu dukën si dy skulptura.

Kamarieri u solli kafetë atyre dhe Lukrecias në një tabaka të vogël dhe me kujdes ua vuri në banak. Dy minatorët panë me çudi kamarierin që u solli tri kafe, ndërsa ata kishin porositur dy. Kamarieri vuri buzën në gaz dhe u tha se e treta ishte e shoqes.

Ai, që kish në dorë çekiçin u koll, tjetri zgjati dorën e tij të madhe e të ashpër për të marrë filxhanin e Lukrecias dhe për t'ia afruar asaj, po, sapo zgjati dorën e tërhoqi me të shpejtë, sepsë në çast edhe Josifi kish zgjatur dorën e tij të hollë, të bardhë e të pastër. Të dy minatorët e vështruan dhe mbetën të habitur. Lukrecia atyre iu duk tepër e bukur, delikate dhe tepër e pastër dhe, padashur, të dy u kthyen nga ajo dhe duke e parë filluan të pijnë kafetë që kishin filluar të ftoheshin.

-Nga ju kemi? - pyeti ai që kishte në dorë çekiçin.

-Nga Tirana, - u përgjigj me të shpejtë Lukrecia.

-Shkoni për në Peshkopi? - pyeti tjetri dhe e pa drejt e në sy Lukrecian e iu duk se pa një livadh të bukur.

-Po, jemi një grup teatral, shkojmë për të dhënë shfaqje.

-Ashtu ? - tha tjetri i habitur.

-Po, - përgjigj Lukrecia.

-Po tek ne, nuk do të jepni shfaqje?

-Jo.

-Si është e mundur! Të kaloni këtej dhe të mos jepni shfaqje tek ne? Dreq o punë! Ne sikur s'rojmë në këtë dynja.

-Ku di unë, - u shfaqësua Lukrecia, duke mbledhur supet delikate e, me një vështirim të trembur kaprolli, si të ishte para dy ujqërve të uritur, të cilët do ta kullufitnin pa e përtypur fare.

Josifi u afrua si për të mbrojtur Lukrecian e brishtë e të stepur.

-Ti je përgjegjësi i trupës? - e pyeti gjithë inat minatori.

-Jo. Jam gazetar.

-A, gazetar? Vetëm ju gazetarët shkëlmi te ne, bile zbrisni dhe në galeri e shkruani sikur keni vizituar parajsën.

Tani u tremb Josifi. Ku donte të dilte ky minator, ky njeri shkëmb. Pse ishte aq i ashpër edhe në pamje dhe në fjalë ?

-Ç'kërkoni nga ne, - tha Lukrecia duke vazhduar të shikojë jo më me firkë, po gjithë kureshtje.

-Përgjegjës in tuaj. Mbase na plotëson një dëshirë.

Lukrecia dhe Josifi nuk e pritën që ata dy ujq të bëheshin dy dële, në sytë e të cilëve lindi një shpresë.

Lukrecia pa në sallë. Në të gjitha tavolinat ishin ulur njerëz me xhupa pambuku, me kapele minatori prej sholle të fortë dhe të gjithë bisedonin me zë të lartë.

-S'qenka, - tha Lukrecia, - do të jetë në autobus.

Sa mbaroi ajo fjalën u dëgjua boria e makinës, që thërriste të

vonuarit.

-Me siguri do të jetë në autobus, - përsëriti Lukrecia.

Minatori pagoi tri kafetë dhe bashkë me Lukrecian dolën nga klubi. Ai eci përpara me një hap të rëndë e të vendosur. Ecte i sigurt, duke mbajtur të përkulur kokën e kurrizin, sikur të kishte firkë të mos përplasej me qiellin e lartë.

-E paske ndërruar gazetarin me minator, Lukrecia, - tha një nga aktorët më të qeshur kur i pa të afroheshin.

-Ky është regjisori dhe përgjegjësi ynë, - i tha Lukrecia minatorit, kur hipën në autobus.

-Më falni, - nisi të flasë minatori dhe i zgjati dorën regjisorit, - unë jam përgjegjësi i turnit, Ndoc Luka. Rastësisht, në klub, mësova nga shoqja se juve jeni një trupë teatrale dhe se po bëni një turne. Sigurisht, ju keni planin tuaj, po ne dëshirojmë që të qëndroni sonte këtu. Skena e kinemasë sonë është e madhe. Nuk do të ishte keq sikur të na kënaqnit sonte.

-Nuk mundemi, - ia preu fjalën regjisori, - nuk e kemi planifikuar.

-Planifikojeni të shkretën, - tha me të qeshur Ndoc Luka.

-S'varet prej meje, - u justifikua regjisori dhe i bëri meshenjë shoferit që të nisej.

-Jo, jo, juve s'keni për t'u nisur, nguli këmbë Ndoci, - këtu punojnë nën dhe disa qindra njerëz dhe ata kanë të drejtë të shplohden e të argëtohen, pavarësisht se juve keni harruar t'i planifikoni.

-Unë mendoj se shoku ka të drejtë, - tha Lukrecia.

-Aq më tepër që këtu paska edhe skenë të përshtatshme, - tha Gazmendi.

-Unë s'kam bileta, - u ankua arkëtari.

-Atë punë e rregullojmë, - u përgjigj i lëkundur regjisori.

-Shumë mirë, - ndërhyri i gëzuar Ndoci, - unë po shkoj të zë gjithë hotelin për ju, hotelin e kemi të vogël, disa prej jush do të flenë

në ndërtesat e punëtorëve.

Gazetari, gjatë gjithë kësaj bisede të shkurtër, vështronte Lukrecian dhe, kur ajo filloi të zbresë përsëri nga autobuzi me valixhen e saj, përsëri e vështroi dhe u bind se ajo s'ishte vetëm e bukur. Sytë i qeshnin si të një fëmije të gëzuar. Ajo u drejtua përsëri për në klub dhe filloi të ngjisë shkallët ngadalë. Josifit iu duk sikur ajo ecte ashtu kastile që t'i linte atij kohë ta arrinte te dera e klubit. Ai e ndoqi dhe ndjeu për të parën herë t'i rrahë zemra që po i afrohej asaj, ndjeu gjithashtu një ndrojtje e frikë siç mund të ndjejë çdo mashkull, kur vëndos t'i afrohet një femre që i pëlqen.

Ajo arriti derën e klubit. Sapo këmba e saj ceku pragun, ktheu kokën dhe pa një hap më tej gazetarin. Në sytë e tij Lukrecia dalloi diçka që s'e kish vënë re më parë. Kur u gjendën të dy pranë njëri-tjetrit, të ulur në tavolinën afër dritares, ndjenë se ishin të shqetësuar që të dy dhe për të njëjtën arsye : sepse të dy ishin pranë njëri-tjetrit.

Shqetësimi që ndjeu, Lukrecias iu duk i këndshëm, i lehtë dhe i trishtuar. Ajo hiodhi sytë në dritare dhe, ndonëse jashtë vapa e verës së gjatë e të thatë kish zhuritur gjithë lëndinën buzë përroit, iu duk sikur sapo kish zënë të rritej bari.

-Kushedi sa bukur do të jetë këtu në pranverë, - tha Lukrecia pa i hequr sytë nga dritarja.

Josifi vështroi malin e lartë që ngrihej përnjëherësh nga lëndina e thatë dhe nisi të flasë duke ndjerë një lehtësi në shpirt.

-Po. Pranvera këtu është e gjatë dhe e freskët, sepse dëborë e këtyre maleve mezi shkrin. Përrenjtë gjëmojnë nga ujërat që vërshojnë në luginë. Dikur këtu krijoheshin pellgje të mëdhenj nga ujërat e dëborës. Atëhere të dy malet përkarshi pasqyroheshin si në pasqyrë nga ujërat dhe a e di se si dukej ?

Lukrecia ktheu sytë dhe pa Josifin. Në sytë e saj kish rënë vërtet pranvera për të cilën fliste Josifi. Ajo e vështroi drejt në sy

gazetarin dhe ai pa veten të pasqyruar në të dy sytë e saj.

-Si dukej? - pyeti Lukrecia.

-Dukej sikur ishin dy qiej, njëri më i bukur se tjetri, njëri lart e tjetri i pasqyruar poshtë me majat e maleve tërë dëborë.

- Ç'urdhëroni, - ndërhyri kamarieri.

-Asgjë, asgjë, - tha Lukrecia me të shpejtë e me një zë të prerë që kamarieri të ikte sa më parë.

-Jo, jo, - ndërhyri Josifi, - sill dy birra.

Kamarieri u largua, po Lukrecia nuk pa me sytë e mendjes as qiell të dytë, as majë malesh me dëborë. Jashtë dritares vera ish e thatë dhe e verdhë.

Pas pak kamarieri solli dy gotat e birrës.

- Gëzuar, Lukrecia !

- Gëzuar, - tha ajo dhe ngriti gotën e birrës.

-Më pëlqeka këtu, - tha ajo përsëri, duke hedhur sytë nëpër sallë.

-Ti ke një shpirt të pastër e të thjeshtë, Lukrecia, - tha Josifi dhe vuri re që ajo psherëtiu e u ngrys.

-Psemë thërret Lukrecia ? U bënë dy ditë që po me këtë emër më flet, mos vallë s'të pëlqen emri Zoica ?

-Në se të kujtohet, dje apo pardje, kur u prezantuam, më the se këto dy javë të turneut ti je Lukrecia, - tha Josifi qot, ashtu siç ndodh shpesh në biseda që secili përpiqet t'i imponohet tjetrit dhe nuk vuri re sytë e saj që u megjulluan e u trishtuan. Vetëm kur ajo heshti një copë herë dhe psherëtiu, ai u habit. Lukrecia i kishte sytë tërë lot dhe ishte aq e emocionuar sikur të ndodhej para një të papriture të cilën ajo e kishte dëshiruar aq shumë dhe ja tani, do t'i plotësohej ç'kishte ëndërruar.

-Sa mirë do të qe sikur të kish mundësi njeriu që të fillonte përsëri një jetë tjetër, të merrte një emër tjetër e të fillonte...

-Që nga fëmijëria? - pyeti Josifi, i cili akoma nuk po kuptonte

se ç'po ndodhte me këtë vajzë të çuditshme.

-Jo! Jo aq larg jo, që nga ky çast, - tha ajo dhe u skuq.

-Mirë pra, unë po vazhdoj të të thërres Lukrecia.

-Vetëm emri është pak!

-Hë për hë emri le të jetë fillimi, - tha Josifi, duke e vështruar

në sy.

Sytë e saj qeshën trishtueshëm. Dhe ashtu, si e përhumbur, ajo tha :

-Duke vështruar fushën e djegur nga dielli dhe duke të dëgjuar ty që flisje, m'u duk sikur përjashta po rikthehej vërtet pranvera.

-Kur njeriu e ndjen veten të lumtur, i duket sikur është vërtet pranverë. Harron çdo të keqe që mund të ketë ngjarë, dhe s'beson se

...

Lukrecia. lëvizi dorën në ajër, përzuri dy miza që i vinin vërdallë gotës së birrës dhe , sikur në çast të kishte ardhur dimri e jo pranvera për të cilën po flisnin , tha :

- Dukesh që je shkrimtar.

-Pse ?

-Sepse beson në atë që ëndërron. Ja, unë, pak më parë, besova se përjashta po vinte pranvera, se po mbinte bari se... se dhe unë mund të rilind, mund të rikthej kohën... E lemë këtë muhabet, - tha Lukrecia tepër nervoze dhe sërish filloi të përzejë mizat që uleshin e ngriheshin në buzët e gotës së birrës.

Kamarieri solli edhe dy gota birrë.

Lukrecia ngriti kokën :

-Ç'ke ndërmend të bësh, mos do të më dehësh ?

-Pse ? - pyeti Josifi i çuditur.

-Si pse, unë po të pi edhe këtë ...

-Çfarë ?

-Dehem , - tha Lukrecia.

-Megjithatë, ti do ta pish, - guxoi e tha Josifi, sytë e të cilit shkëlqenin.

-Për ty? - pyeti Lukrecia.

-Jo për mua. Për atë pranverë që dëshiron të të lindë në shpirt.

Dora e saj u drodh lehtë kur u zgjat të kapte gotën.

* * *

Pas shfaqjes, vonë, ata hëngrën darkë bashkë dhe kurrë në klub s'kishin mbetur veçse disa minatorë, u ngritën ngadalë dhe dolën përjashta.

Nata ishte e bukur dhe e ngrohtë. Në qiell yjet pranë njëri-tjetrit digjeshin ngadalë. Në faqen e malit dritat e shumta të galerive dhe të rrugës dukeshin si yjet e një qielli të dytë, kurse tutje, thellë fushës së Vajkalit, nga avujt e ditës së nxehtë, hëna ndriçonte zbehtë qiellin e madh me yjet që digjeshin ngadalë dhe qiellin e vogël në faqen e malit. Dhe ata të dy ecnin në rrugën e fjetur, si të ish rruga e pluhurosur Kashte e Kumtrit që ndante të dy qiejt. Josifi ngriti krahun dhe e mbështeti në supin e saj. Ajo u lëkund si degëz shelgu kur e shtyn era dhe përkuli kokën në supin e tij. Ai ndjeu ngrohtësinë e

trupit që e pat dehur një natë më parë, në pistën e vallzimit në Burrel. Josifi nuk besoi atë që po ndodhte, që dora e tij kishte pushtuar belin, që koka e saj ishte mbi supin e tij, që kjo vajzë kaq e brishtë, kaq e çuditshme, të cilën e njihje më shumë si personazh të Holbergut, si një shërbëtoreshë hoteli e që quhej Lukrecia, të ishte e tija dhe për çudi larg çdo syri kureshtar, larg atyre vështrimeve tizare pas gëmushave të lulishtes së Burrelit, të kalimtarëve të rrugës, të spektatorëve të shumtë, larg çdo dëshmitari. Ai dhe ajo ishin vetëm të dy. Nuk kishte kush t'i shikonte atë natë. Mes fushës së Vajkalit ishte vetëm hëna

dëshmitarja e heshtur e dashurive dhe e yjeve të largët, që nuk i përkasin kurrkujt e megjithatë i përkasin të gjithëve.

Josifi u hutua për një çast. Ndonëse ai kishte aq pranë trupin e saj, sa ia ndiente se si i lëvrinte gjaku i ngrotë, që ia ndjente flokët e saj në qafën e faqen e tij, që dëgjonte dhe frymën e saj nuk mundi të vepronte: të kthente sadopak kokën, të lëvizte fare pak, ta përkulte jo më shumë se një gisht dhe të arrinte atë që s'mund ta realizonte i ë pistë; të shijonte, ta prekte me buzët e tij të etura lëkurën e saj, faqet apo buzët.

Nëse në pistën e vallzimit u ndrojt nga opinioni, këtu, kush po e pengonte? Nata? Yjet, apo hëna? Apo poezia? Ç'priste më ai? Ngadalë mori kokën e saj me duar dhe ia ktheu hënës. Pas pak koka e tij bëri hije në fytyrën e saj dhe ata të dy ngadalë u shkrinë me njëri-tjetrin, lëshuan në lëndinën e barit të thatë të fushës së Vajkalit, që flinte vetëm një hije, që lëkundej dhe hepohej lehtë, sikur në fushë të frynte vetëm një erë, era e dashurisë.

Që të besonte se ç'po ndodhte ishte e vërtetë, Josifi pëshpëriti emrin e saj :

-Lukrecia !

Ai e dëgjoji zërin e tij që tha emrin e saj. Pas pak dëgjoji dhe zërin e saj :

-S'jam Lukrecia.

-Zoica, - pëshpëriti ai po me atë epush e dëshirë që t'i mbushte mëndjen vetes së tij se ishte me atë.

Ajo nuk iu përgjigj. Me t'u dëgjuar emri Zoica, gjithshka u ftoh. Dhe gjaku në trupin e saj u ftoh, u ngri. Dhe ajo vetë u ngurtësua si me magji. Midis tyre sikur mbiu një ferrë me gjëmba. Ajo u tërhoq. Dhe hëna dhe yjet u ftohën.

* * *

Të nesërmen në mëngjes autobusi i vogël u nis shpejt. Lukrecias i dukej sikur ai fluturonte. Fusha e Vajkalit, që mbrëmë, nën dritën e hënës dukej e pafund, si një botë e vogël, mbaroi sakaq. Makina ktheu përnjëherësh dhe u fut midis maleve, të cilët dolën pa prituri, si të ishin male të një bote tjetër, megjithatë, Lukrecia ndjeu përsëri në shpirt gjithë poezinë e natës së shkuar dhe në buzë afshin e puthjes. Ajo do të donte që autobusi i vogël të ecte vazhdimisht, ditë, natë, vite, mbase dhe gjithë jetën e jetës, veç në shpirtin e saj të ringjallej dhe një herë ajo ngrohtësi dehëse që kish lëshuar hëna mbrëmë dhe në buzë të mbetej përjetësisht ai afsh dehës i asaj puthjeje.

Makina ecte dhe ajo s'ish përmendur, akoma ishte si midis dy botëve, midis natës së kaluar dhe botës së re, dhe, si të ishte një vajzë e re, e puthur mbrëmë për të parën herë në jetën e saj, i vinte turp të shikonte shokët në sy, sidomos Josifin, i cili, kur e pa të hipte në autobus vrenjtur dhe e hutuar, pandehte se mos ajo ish penduar për çka kish ndodhur natën e kaluar, po nga ky mendim hoqi dorë sapo ndeshi shkarazi vështrimin e saj të ëmbël e të butë, të ngrohtë e të përgjumur, dhe, kur ajo u ul në vendin e saj, pranë tij, ajo s'u kujdes fare. U ul, ose më mirë u mbështet pas tij dhe vështrimin e ndeu në fushën e Vajkalit të djegur nga vapa.

Josifi desh të tregojë historinë e kësaj fushe të bukur me emër të trishtuar, po fusha mbaroi shpejt, aq shpejt sa atij iu duk sikur ajo që ndodhi natën e kaluar kish ndodhur vite më parë, mbase atëhere, kur kish ndodhur edhe ngjarja që i kish dhënë emrin fushës, atëhere, kur pas betejës së përgjakshme me turqit, kuajt vajtonin mbi kufomat e të zotërve të vrarë, që i ndriçonte hëna e kuqe.

Josifi desh t'i fliste Lukrecias, po ajo kish ulur xhamin e dritares, kish mbështetur brjlet në parvaz dhe me kokën pak të anuar mbi sup rrinte e heshtur dhe vështronte përjashta, si e hutuar, sikur shikonte vërtet natën e betejës së Vajkalit dhe ndjente erën e fushës

që ia rrëmbente flokët e verdhë. Pas pak ajo futi kokën përbrenda.

Në autobus kish filluar loja e bixhozit dhe shamata. Dikush kish bërë hile. Regjisori shante me të madhe, kurse të tjerët qeshnin.

Lukrecia puliti sytë dhe iu duk sikur ata që bënë shamatë ishin fëmijët e saj, kurse i ati i tyre, Josifi, rrinte duarkryq dhe i shikonte me kënaqësi se si zreshin. Ajo përsëri puliti sytë dhe, si të ish zgjuar nga ëndrra e ëmbël, pa vetëm sytë e qeshur e të butë të Josifit.

-Po ti pse s'luan me ta ? - pyeti Lukrecia.

-Më pëlqen më tepër të rri pranë teje, - qeshi Josifi.

-Ashtu ? - pyeti e çuditur Lukrecia.

-Po.

-Atëhere afrohu edhe ca.

-Nuk bën, ata mund të mendojnë... - vazhdoi po me të qeshur Josifi.

-E ç'rëndësi ka se ç'mendojnë ata? - tha Lukrecia dhe përmjeherësh iu tret gëzimi.

Në sytë e saj të pastër e të kaltër sikur ra në çast një re e zezë dhe përmjeherësh biseda e tyre u ngrys. Ajo e ndjeu se tashti do të fillonte një bisedë e gjatë dhe e mërzitshme mbi opinionin e të tjerëve, mbi sakrificat që duhet të bëjmë për hir të fjalëve të botës, ose për hir të atyre që na njohin, ose për hir të asaj pozite që kemi në jetë e shumë e shumë gjëra të tjera të vogla, që ia ngushtojnë shpirtin njeriut dhe s'e lenë të mbushë gjoksën me frymë...

-Sigurisht, që s'ka rëndësi, - tha Josifi me të qeshur dhe u habit me atë që po ndodhte në fytyrën e saj.

Lukrecia mezi u qetësua dhe mori frymë lirisht, sikur shpëtoi nga një barrë e rëndë. Sikur për hiç gjë të kish nisur biseda mbi opinionin, Lukrecia do t'i kish treguar atij, nga eksperiencia e saj, se sa gjë e shëmtuar është kur njeriu bëhet rob i opinionit të të tjerëve dhe pushon së jetuari më për veten e tij, duke nisur një jetë tjetër të zvarrisur, të coptuar nga dhjetra opinione, të dhjetë njerëzve të

veçantë.

Lukrecia u mundua të buzëqeshë përsëri, të rikujtojë natën e shkuar me yje e hënë dhe e rikujtoi, po yjet në mendjen e saj s'qenë më të ndezur e të ngrohtë dhe hëna sikur ish tjetër hënë. Ajo ktheu kokën nga dritarja, që ai të mos shihet as yjet e zbehtë, as hënë e ftohtë.

-Lukreca, ti se ç'ke ?

-Asgjë, - tha ajo dhe me një shkathtësi të habitëshme kaloi nga ajo gjëndje e ndrydhur në një gjëndje tjetër, të gëzuar.

-Ti dukesh e mërztur, Lukrecia, - nguli këmbë Josifi, i cili nuk u besoi syve kur pa atë ndryshim që pësoi Lukrecia.

-Po, - tha ajo, si e zënë në faj.

Në fytyrën e saj, në sytë e saj, në buzët e saj ra sërish një gjëndje e mërztishme.

-Do të të tregoj diçka të bukur për fushën e Vajkalit?

-Jo.

-Pse?

-Sepse e di çdo të më thuash.

Josifi sikur ngriu nga përgjigja e saj. Ajo zgjati përsëri kokën jashtë dritares dhe era përsëri filloi të tallet me flokët e saj të verdhë e të gjatë.

Makina ndaloi. Josifit iu duk sikur ndaloi vrapin një kope kuajsh të trembur.

-Ku jemi ? - pyeti një nga aktorët, duke ngritur dorën lart e duke marrë një pozë prej kalorësi.

-Keni të drejtë të pushoni dhjetë minuta, - tha shoferi, zbriti nga makina dhe hapi kofien. Nga motori u ngrit një re e bardhë avulli.

Pas tij zbritën të gjithë, me përjashtim të Lukrecias dhe Josifit. Ata mbetën të dy të heshtur pranë njeri-tjetrit. Përjashta vapa ishte aq e madhe, sa të merrej fryma. Në oborrin e ndërtesës përballë, që duhej të ishte kryesia e kooperativës, ishin lidhur disa kuaj. Më tej,

dy qe të shtrirë paq nën hijen që lëshonte ndërtesa, përtypeshin qetësisht e me nge. Herë-herë qetë shfrynin hundët si për të përzënë vapën që mbante erë pleh, kurse kuajt lëvizin bishtin dhe tundnin leqet për të përzënë mizat.

-Vapë, - u ankua Lukrecia.

-Dalim. Mbase përjashta, në hije, është më freskët.

-Njësoj është kudo, - tha Lukrecia, - më mirë shkojmë në klub, me siguri do të ketë arançatë.

Josifi zbriti i pari nga makina dhe priti Lukrecian. Ajo bëri ballë te dera e hapur e autobusit me një pozë teatrale, sikur të ishte princeshë e jo shërbëtore e një hoteli të Kopenhagës. gjithë elegancë zgjati krahun e bukur. Josifi pa sqetullën e saj pa qime, pa qafën e saj të gjatë si të mjelmës. Kur i kishte mbledhur flokët topuz mbi kokë? Duke zbritur ato tri shkallë të autobusit Josifi pa se sa të gjata ishin kofshët e këmbët e saj të drejtë e të hollë. Dhe fustanin, që ajo e kishte pas veshur që në mëngjes Josifi e pa tani. Ishte një fustan basme nga të kombinatit të tekstileve, me hule dele të verdha në një fushë të gjelbër të dalë boje, sikur dhe atë ta kishte djegur dielli. Krahu që kishte zgjatur Lukrecia mbeti në ajër. Josifi e kuptoi me vonesë dëshirën e saj ndaj nxitit dhe, kur ajo po bëhej gati të ulte këmbën në tokë, ai zgjati dorën e tij, rroku pëllëmbën e saj dhe pa ia lëshuar, u nisën të dy për në atë qendër të vogël të lokalitetit, si të ishte aty qendra e botës : zyrat e kryesisë së kooperativës, klubi, postë - telegrafi dhe ajo pikë e vetme e policisë, me të vetmin polic, kapter Selimin, i cili zgurdulloi sytë kur, më në fund, arriti të bëjë lidhjen, që kjo grua me ato krahë lakuriq deri mbi supe, me atë qafë të gjatë, me atë gjoks gjysmë të hapur, me atë fustan të ngjitur turpërisht pas trupit; me ato gjunjë gollomesh ishte po ajo zuskë që mbrëmë, në skenën e shtëpisë së kulturës, pat dalë pothuajse lakuriq me atë këmishë nate aq të hollë sa turbulloi gjithë minatorët e Bulqizës, duke u puthur pa pikë turpi me atë bukuroshin të veshur si dordolec, bile dhe me flokë të gjatë si

gagarel.

Kapteri picërroi sytë, fytyra e kavalierit që vazhdonte ta mbante për dore vajzën, meazallah se i shëmbëllen me atë të aktorit të mbrëmshëm. Dhe të tjerët, gjithë ç'kishin dalë kureshtarë të shikonin atë autobus rrangallë të firmës "Fiat", i mbetur që pas luftës, panë me çudi Lukrecian, sikur të mos kish ardhur deri aty me autobus, po të kish zbritur si nga qielli. Dhe Lukrecia, duke qenë një aktore e lindur, tepër e talentuar dhe jashtë çdo norme, e lirë si era, ndjeu se po shikohej. Sytë e kureshtarëve e ngacmuan atë, dhe ajo, si për dreq, vazhdoi të luajë, të ecë si në skenë, tamam sikur po jepte njëshfaqjenë natyrë, nga ato që shpesh herë trupa e tyre improvizonte nëpër fshatra, kooperativa, aksione të rinisë, ku sajohej në mënyrë simbolike vetëm perdja me dy çarçafë ose batanie, kurse skenë e dekor ishte vetë natyra, sido që të qëllonte : një lëndinë pranë mullarit, ose koçekët e misrit, një hangar apo faqe barake dhe të gjitha këto lloj skenash kishin në të majtë ose të djathtë autobusin nga ku hynin e dilnin aktorët dhe ndërronin kostumet.

Gjithë kureshtarët dhe kapterin, dhe kryetarin e lokalitetit, i cili doli nga zyra dhe po bënte sehir pranë kapterit, Lukrecia me atë sedër të përkëdhelur prej artisteje, në vend që të komunikonte me ta, siç bënte zakonisht kur ishte në podium të skenës, duke i elektrizuar me atë magji joshëse, i injoroi të gjithë. Ajo, me sa dukej, po e bënte atë kapriço për qejf të saj, duke ndjerë vërtet në shpirt një liri veprimi e sjelljeje, ashtu siç iu shkrep. Mirëpo dhe kapter Selimi dhe kryetari nuk ishin mësuar që në qendrën e tyre të lokalitetit, të asaj bote të vogël, të kalonte njeri para hundës së tyre pa i përfillur.

Të dy u panë sy më sy, vetëm një çast, sa mban një shkrepëtime dhe të dy u ngrysën.

-Kjo është ajo, e mbrëmshmeja, që doli çiplak në skenë e që u puth në Bulqizë, - i pëshpëriti kapteri, kryetarit.

-Hëm! Dhe tani na hedh vickla këtu!

-Bëri dhe sikur nuk më pa, pale. Po ky zdapi i gjatë, pse e mban për dore ?

Kapteri mblodhi supet e përdroldhi buzët, kurse Josifi, që atë çast kishte mbetur te dera e klubit, i lëshoi dorën, bëri një përkulje të trupit, bëri një reverancë, duke rrotulluar në ajër dorën dhe i tregoi derën e hapur.

-Bukur, - tha e kënaqur Lukrecia, - paske talent! Pse s'vjen të luash teatër me ne?

-Me ty jam gati të vijë edhe në ferr! - iu përgjigj Josifi, duke u munduar të imitonte atë mënyrë të foluri e veprimi skenik, që kishte parë në Burrel e Bulqizë.

Lukrecia u kënaq nga loja e Josifit. Në çast ajo mbaroi së luajturi kapriçon e saj, u kthye si me magji në spektatore dhe përplasi duart. Në fakt, ajo, atë çast, desh ta përqafonte Josifin, ta puthte, po u step sa pa sytë me një vështrim prej ujku të njeriut të veshur me rrobe polici, aty, dy hapa tej derës.

Në fytyrën e Lukrecias ranjë hije e zbehtë, sikur në çast gjithë gjaku i saj i ngrohtë, gjithë ai gëzim i asaj loje apo shakaje të improvizuar, u ngri, u nxi. Në ballë i mbinë tri rrudha dhe anash syve i mbinë dy-tri vijëza të holla. Si nuk i kishte vënë re më parë Josifi ato rrudha? Një aktore e shkëlqyer mund të të bëjë të besosh që me dy apo tri çaste të të japë dy apo tri shprehje, gjëndje shpirtërore, po kurrsesi të sajorë rrudha pa dalë nga skena, pa u ulur në pasqyrë e pa marrë lapsin.

Josifit iu dhimbs. Iu duk sikur Lukrecia u plak në çast dhe u bind se Lukrecian e bënte apo e mbante të bukur, joshëse, të freskët e të gëzuar ajo gjëndje e lumtur dhe tepër e lirë, e lirë si era. Kush e thau atë freski dhe fashiti atë gëzim ?

-Kjo është ajo, - dëgjoji Josifi të pëshpëritet nga një grup vajzash që rrëshqitën pranë tij. Vajzat, si gjithë kooperativistet, ishin veshur me pantallona doku e, sipër pantallonave, funde prej basme.

Dhe në kokë u zbardhnin shamitë prej nape, që i mbronte nga pluhuri e vapa. Vajzat gati sa nuk shtangën para Lukrecias. Gjithë gratë e tjera, gati një brigadë, që ishin strukur në hijen përgjatë hangarit, kur e panë se dy vajzat s'pësuan gjë, nuk i trembi e nuk i përzuri kryetari, morën kurajo nga njëra-tjetra dhe ashtu, të hutuara e të habitura, nisën të afrohen.

Ato, kureshtare e të ndrojtura, ishin gati të vdisnin, veç ta shikonin nga afër artisten që u kishte turbulluar mendjet burrave e djemve të fshatit, jo vetëm atyre që punonin në minierën e Bulqizës e që e kishin parë me sytë e tyre lakuriq, po dhe gjithë të tjerëve. Të parat e morën vesh se ç'kishte ndodhur në Bulqizë gratë e martuara që kishin burrat në minierë. Ata, me t'u kthyer me autobusin e fundit, që u nis pas shfaqjes, zgjuan gratë nga gjumi dhe u pëshpëritën në vesh ç'u kishin parë sytë: një shtojzavalle me këmishë nate gjysmë lakuriq që u puth para gjithë ç'ishin mbledhur në kino-teatrin e qytezës. Dhe meqë ajo shtojzavalle lavire qe hargalisur me një palo burrë me flokë të gjata grash, secili minator i jepte të drejtë vetes se ajo lakuriqësirë duhej ta kishte për nder të flinte me ta, që ishin burra të rinj e aq të fuqishëm, sa luftonin në zemër të malit. Atë natë pati edhe nga ata burra të rinj e të fortë që mposhtën vetveten e në epsh e sipër, sipër grave të tyre, imagjinonin veten se ishin sipër shtojzavalles, deri aty sa grave të shkreta iu çakërritën sytë në errësirë, kur burrat u ndërruan emrat dhe pëshpëritën jo Drane, Mazi e Nusi, Shegë e Nure, po një emër të ri: Lukrecia.

Dhe ja, Lukrecia, që mbrëmë ia kishin dëgjuar emrin të pëshpëritej gjithë epsh nga burrat e tyre, tani ndodhej te dera e klubit.

-Po ju, moj shushka, ku vini kështu si bagëtia, ? - u shfryu kryetari, i cili e ndjeu veten të fyer, qënjë brigadë grash e vajzash, para syve të tij, lanë punën e shikonin pa pikë turpi Lukrecian, sikur kjo çupërlinë të mos ishte një zuskë nga ato të thiatrove, që dredhin bishtin, po një perëndeshë, një shtojzavalle e dalë nga bregu i lumit.

Gratë, ashtu tufë siç ishin, shtangën nga zëri i kryetarit dhe u trembën si delet.

-Lanet, turp të kini!

Gratë u kthyen po tufë. Më të guximshmet e panë dhe një herë Lukrecian, floçkën, që u kishte prishur mëndjen burrave. Drania, për të cilën fshati këndonte : "Mori e mira kur del te sana, sa një martinë vithet e gjana", përdrodhi buzët, si me neveri. Asaj floçka i doli kllloçkë, nga ato qafë rrjepurat e shalë gjatat, që as gjeli më i dobët i fshatit nuk ia ngul sqepin. Ajo përdrodhi buzët me neveri dhe u foli shoqeve :

-Po ma zu burri edhe sonte në shtrat emrin e kësaj shkarpe, do ta mbys.

Lukrecia u zbeh në fytyrë. Ç'donte emri i saj në shtratin e asaj gruaje?

Josifi bëri sikur nuk dëgjoi, po me sytë e mendjes ai pa gruan që foli krejt lakuriq, të shtrirë në shtratin e gjumit dhe mbi atë masë mishi e dhjami pa të shoqin, një nga ata minatorët e Bulqizës, që i përhumbur në ekstazë, pëshpëriste me sy mbyllur emrin e Lukrecias. I trembur se mos shikonte se si ajo do ta mbyste burrin e saj hapi sytë. Atë çast pa gishtin e kapter Selimit që lëvizi në ajër dhe atë shenjën urdhëruese kuptimplote:

- Ti, eja këtu !

Me ç'të drejtë ky polic lokaliteti, buzë rrugës, mes malesh, në qendër të kooperativës, e thërriste ashtu ? Kush ia jepte atë fuqi gishtit të tij ? Pse iu bind? Atë çast, që këmba u nis drejt policit, dora e tij lëvizi nervoze dhe endaloi Lukrecian që ta ndiqte pas. Po atë çast, Josifi pa se nga arat e kooperativës e nga shtëpitë rreth e qark, po afroheshin njerëz.

Polici, që me sa dukej kishte kryer gjysmën e misionit të tij, mori një pozë qetësore, po njëkohësisht ishte i gatshëm që të vepronte. Dukej fare aqik që ai, siç thonë aktorët, po luante atë pushtet

që i jep uniforma dhe ligji.

-Çfarë doni? - tha Josifi, duke iu drejtuar të dyve, dhe policit dhe atij burrit me ballë të gjërë, të mbushur gjithë rrudha të thella, si brazda. Sytë e tij bojë hiri, me një vështrim dinak e të hidhur, sikur u kënaqën, sikur u përkëdhelën.

Josifi nuk e dinte që kishte të bënte me kryetarin e pushtetit të atij lokaliteti, veç në çast, nga mënyra se si u vështrua nga ai, kuptoi se ky njeri ç'është në atë humbëtirë.

-Dëgjo këtu, more çun! - nisi të flasë me përtesë kryetari duke u munduar të përmbante veten.

-Si urdhëron, po ju dëgjoj, - tha me kurajo Josifi, i cili gjithashtu u përpoq të përmbante veten.

Polici bëri habi se si kryetari po e duronte këtë kokoroç të pispillosur.

-Merr shokët dhe atë pilivickën, hipni në makinë dhe vazhdoni rrugën për në Peshkopi. Boll qëndruat këtu.

-Nga e dini ju që po shkojmë në Peshkopi? - pyeti Josifi.

-Ne i dimë të gjitha. Dhe ç'ndodhi mbrëmë në Bulqizë e dimë.

-Veç unë s'po e lidh dot fytyrën e këtij me atë të skenës - ndërhyri polici, duke parë me dyshim e duke përdredhur buzët gjithë siklet, i pëshpëriti kryetarit: - ky duhet të jetë ai i passhfaqjes që doli andej nga shelgjet.

Josifi hapi gojën të fliste po kryetari, pa u ndrojtur fare, zgjati dorën e tij sa një putër ariu dhe, me pëllëmbën e plasaritur, ia zuri gojën dhe gjithë inat shfryu:

-Nuk e di kush e ka aprovuar shfaqjen tuaj, kush e ka miratuar dhe turneun. Atë do ta shohim më vonë. Tani merr shokët dhe nis. Pa shiko një çikë rreth e qark, ë? E vë re se ç'lëvizje ka në fshat? Po lenë punët njerëzit dhe po vijnë këtu gjoja për të pirë një gotë dhallë, ë? Aq duan njerëzit sa të binden se ajo që doli lakuriq, u puth

mbrëmë në skenën e Burrelit e Bulqizës erdhi e piu dhallë te ne, dhe te dera ishte vetë kryetari me kapter Selimin e ata s'morën asnjë masë.

Josifi ktheu kokën i trembur nga Lukrecia, që kishte mbetur aty te dera. Fytyra e saj qe e zbehtë, si pa gjak dhe sytë e mëdhenj ishin kërkues. Ajo gati sa nuk e mbërtheu Josifin me vështrimin e saj pyetës.

Josifi, i cili me zor të madh kishte përmbajtur vetveten në t'isedën poshtëruese me kryetarin tani, para syve të saj, u ligështua duke e ndjerë veten burracak. Ç'kishte bërë për të marrë në mbrojtje Lukrecian, shokët e saj, punën e tyre gjithë pasion, artin dhe misionin e tij? A nuk ishte ai një nga gazetarët e shkrimtarët që mbush faqet e gazetave? A nuk ishte detyra e tij t'i spjegonte atij kryetari kokëgdhë e atij polici se ç'do me thënë art? Po sikur shokët e grupit të mos kishin dalë atë çast nga klubi e u futën në autobus çdo të bënte? Si do t'ua transmetonte urdhërin e kryetarit?

-Çtë thanë ata të dy, ë? - pëshpëriti Lukrecia sapo iu afrua Josifit.

Josifi përdrodi buzët me përçmim.

-Të pyeta se çtë thanë ata të dy? - përsëriti Lukrecia.

-Si është puna? -ndërhyri Shkëlzeni, - s'ju shoh mirë. Kur arritët të zemëroheni me njëri tjetrin kaq shpejt? Për besë po më çuditni!

-Në radhë të parë njeriu duhet të jetë i sinqertë, aq më tepër kur pyetet për diçka duhet të përgjigjet, - thumboi Lukrecia.

-O, sa rëndësi po i jep, - u ankua Josifi.

-Dua ta di, çtë thanë ?

-Ishin të zemëruar që të dy, - nisi të flasë Josifi.

-Kush, s'po marr vesh asgjë, - ndërhyri Shkëlzeni.

-Kryetari dhe polici i lokalitetit, ata dy burrat që rrinin si hunj gardhi te dera.

-Kjo nuk është përgjigje, Josif! - ngriti zërin Lukrecia, e cila

po e humbte durimin.

-Hiç, ata donin që ne, domethënë ju, të jepni një shfaqje këtu në fushë, - gënjeu Josifi.

-Po ne sonte kemi shfaqje në Peshkopi, nuk ua the?

-Atë i thashë.

Një buzëqeshje e hollë, ehidhur, ia përdrodhi buzët Lukrecias. Josifi e pa se si u drodhën ato dy buzë të tulta, ato buzë, që mbrëmë ishin puthur...

Autobusi u nis.

Josifi vazhdonte të shikonte vjedhurazi buzët e Lukrecias, ato dy buzë që kishin tronditur pushtetin e lokalitetit midis qytezës së Bulqizës dhe qytetit të Peshkopisë.

Një pikëllim, si të kishte ndodhur një fatkeqësi e madhe, i rëndoi Josifit në shpirt. Nuk ishte as ai nënshtrim e poshtërim që pësoi nga ajo copë bisedë me kryetarin, nën hijen e policit që binte tamam te këmbët e tij, as mungesa e kurajos për ta sqaruar ose kundërshtuar kryetarin, as gënjeshtër që i bëri Lukrecias, as vapa e zagushia e asaj lugine buzë kufirit, as kufitarët me automatikë pranë lapidarëve, ishte diçka tjetër që po e ndjente për të parën herë dhe i dukej se po e kuptonte. Ai nuk kishte as dinjitet, as personalitet. Ai ishte një hiç. Sikur në krah të tij të mos ishte Lukrecia dhe të mos kishte pas ndodhur gjithë ç'po ndodhte këto dy-tre ditë, ai do të vazhdonte të ishte gazetari i ditës dhe shkrimtari i të nesërmes, do të vazhdonte të bridhte poshtë e përpjetë Shqipërisë, ashtu siç ia donte detyra e të shkruante ç'bukuri do t'i shikonin sytë, e nga gjithë çdo të shkruante do të zgjidhte perlat e tij nja 200-250 faqe të daktilografuara e do të botonte librin e tij të parë, pastaj do t'i kushtojë letërsisë...

Josifi pa vjedhurazi Lukrecian, po jo buzët. Sytë e tij mbeten te qafa e saj, e cila iu duk nga çasti në çast, se ajo qafë do të thyhej. Josifi u bind që letërsia dhe Lukrecia ishin një. Ky mendim e dëshpëroi sikur t'i kishte pasë ndodhur një vdekje. Ai u bind. Nëse

Lukrecia ishte letërsia, ose një subjekt i saj, ai s'do të kishte fuqi ta shkruante.

-Ç'dreqin ke, ç'mendon? - e përmendi Lukrecia.

-Hiç, asgjë!

-Nëse s'do të më thuash, të paktën mos gënje, - tha ajo dhe ktheu kokën e fyter dhe sytë i hodhi tutje, larg, atje, buzë zallit të përroit dhe pa se si ngrihej avulli nga gurët e bardhë, në piskun e vapës e në kulmin e qetësisë. Josifi ktheu kokën dhe vështrroi prapa. Nga që autobusi ishte larguar, lokaliteti iu duk tepër i vogël dhe si i harruar aty midis kodrës dhe fushës.

Për një kohë të gjatë ai nuk i foli. Ç't'i thoshte? Si t'i a thoshte? Ishin dy gjëra që e mundonin: e para, reaksioni dhe kureshtja që kishin mbirë të nesërmen e puthjes në skenën e Bulqizës, njëzet kilometra larg dhe, e dyta, mungesa e guximit të tij për ta mbrojtur atë, së paku, para kryetarit të lokalitetit dhe kapter Selimit, të cilët e detyruan të ikte aq me turp. Heshtja e Lukrecias i erdhi si balsam që i ve kore plagës dhe ai ishte gati të pranonte atë plagë aty, të mbyllur me turp në trupin e tij, ani se një ditë mund ta helmonte. Lukrecia vazhdonte të rrinte strukur në vendin e saj pranë dritares dhe vështronte përjashta, në një mënyrë të atillë sa që Josifit iu duk sikur dhe ajo ish e përgojuar, e turpëruar dhe e braktisur. Në fytyrën e saj të qetë e të hijshme, kish rënë një hije e ftohtë dhe e trishtuar.

Josifit i erdhi si çudi kur kujtoi se natën e kaluar kish përqaftuar pikërisht këtë grua. Pas pak atij iu duk e pabesueshme. Ajo rrinte po ashtu, ë mbledhur në qoshen e saj, pranë dritares dhe nga mënyra si vështronte, dukej se mendjen s'e kish atje, ku kishte sytë. Shikonte diçka e mendonte diçka tjetër, diçka të largët e të shkuar, ose diçka që dëshironte të ndodhte e s'do ndodhte kurrë.

Makina ecte ngadalë dhe ngrinte nga pas një re pluhuri të gjatë sa dhe vetë rruga.

Josifi u mësua me heshtjen e saj të thellë dhe me mënyrën se

si ajo ishte ulur...

Makina filloi të ecë më shpejt dhe pluhuri që ngrihej ajo, hynte pa u dukur nga dritarja e pasme. Të gjithë ishin nëpër vendet e tyre dhe, si të dehur nga vapa e pluhuri, dremisnin.

Josifi e vështroi përsëri Lukrecian dhe ndjeu se s'mund të dashuronte veçse një vajzë të tillë. Ngadalë e gjithë ndrojtje ai ngriti dorën dhe ia vuri në sup. Ajo ktheu kokën. Në sytë e saj ai pa veten e tij.

-Lukrecia, - belbëzoi Josifi.

-Shët, - i pëshpëriti ajo dhe i vuri gishtin te buzët, që të mos flisnin.

-Lukrecia, unë dua të them...

-Më mirë mos thuaj gjë, - ia preu sërish fjalën, po Josifi nuk iu bind.

-Duke të vështruar ty m'u duk sikur ti ishe pranë zjarrit, në shtëpinë time dhe si e zemëruar prisje që unë të flisja i pari.

Lukrecia qeshi dhe ngriti kokën, kurse ai e uli, kështu që ajo s'mundi të shohë sytë e tij.

* * *

Para autobusit sikur mbinë nga dheu një rradhë shtëpish të vjetra e të mëdha. nën to një rrugë e gjërë si shesh dhe disa ndërtesa njëkatëshe me qepene dërrasash të vjetra e të çara.

-Peshkopia, - bërtiti njëri nga aktorët.

Lukrecia u vrenjt dhe me pëllëmbët e saj mbuloi fytyrën si e trembur.

-O zot, ç'qytet! - pëshpëriti ajo dhe në shpirtin e saj të shqetësuar e si të përdhunuar nga vështrimi i policit, ndjeu sikur i ra dikush me një shuplakë të ftohtë. Ajo priste të shikonte një qytet verior, të madh e të pastër, me ndërtesa të reja, të larta, një qytet ku

ajo sapo të zbriste nga autobusi e të hipte në trotuar të humbte midis njerëze të shumtë. Ajo, në kohën kur po lexonte pjesën e Holbergut dhe mundohej me fantazinë e saj ta përfytyronte veten si kopenhgase, si një vajzë e thjeshtë, si një shërbëtoreshë hoteli dhe, pothuajse, po ia arrinte qëllimit të hynte gjithashtu dhe në kohën e autorit, çdo gjë u shthur. Ajo, pa prituri se si vendosi dhe çdo gjë që kishte të bënte me rolin e saj si shërbëtoreshë hoteli para një shekulli, e vendosi në mes të Tiranës dhe hotelin e dramës e imagjinoi si hotel "Pezën" dhe llojlloj mlllefesh që kishte patur në jetën e saj, padrejtësira, poshtërsira, nënvleftësime, përçmime, fyerje, i shfrytëzuar në skenë mjeshtrisht. Kur mori duartrokitjet e para iu mbushën sytë me lot. Si është e mundur vallë që të ndodhte ajo që po ndodhte në plate e në llozhat e "Teatrit Popullor" ? A s'ishin po këta spektatorë, banorë të Tiranës, të Uzinës së saj, të lagjes së saj që e përgojonin, e nënvleftësonin, e quanin dhe të përdalë, që ndërhynin në jetën e saj private, që nuk e linin të jetonte jetën e saj ashtu si e mendonte dhe e ndjente ajo ? Pse kësaj shërbëtoreje nga Kopenhaga ia miratojnë guximin dhe lirinë dhe e duartrokasnin, kurse mua... ?

Lukrecia, mes skenës, e përmbloodhi veten dhe, e etur, e dehur nga ato duartrokitje, u mundua të shikonte spektatorët, që ishin ngritur në këmbë e vazhdonin të përplasnin duart, të njihin një prej atyre, o nga shokët e shoqet e uzinës, o nga aktivistët e Pallatit "Ali Kelmendi", o nga ata të kafeneve, o nga ata që shëtisnin bulevardit dhe i hidhnin thumba... po sytë e saj, të veshur nga lotët e emocioneve, s'dalluan asnjë fytyrë. Gjithë njerëzit e sallës ishin si të vizatuar në miniaturë, tamam si në pllakatet e "I Majit", ngjeshur pas njëri-tjetrit, ashtu siç i kishte hedhur e sajuar peneli i piktorit. Salla e tërë asaj iu duk se ishte mbushur me të atillë njerëz, ashtu siç dëshironte ajo të ishin njerëzit. Pa ardhur akoma në vete, e mbushur plot me drithma rrënoqethëse nga sukcesi, ajo, që për të parën herë ishte puthur në skenë, vuri të dyja duart e saj te buzët dhe, me një

lëvizje tepër elegante, dashamirëse u dha të gjithëve, ç'ishin në plate dhe në llozhë, puthje. Salla u elektrizua.

Kur u mbyll perdja ajo po qante. Regjisori iu afrua dhe pa e fyer i pëshpëriti : - Mos e teprove një çikë, ë?

-Jo. Nuk e teprova, - u përgjigj ajo, sepse në çast ndjeu një frikë, të cilën nuk e shpjegoi dot, por ama ajo frikë e asaj fjale që i tha regjisori, se si i mbeti në shpirt.

Dhe tani që pa Peshkopinë, ajo e ndjeu atë frikë.

-Mos u dëshpëro, Lukrecia, - dëgjoi ajo zërin e Josifit dhe ndjeu dorën e tij në sup, pastaj ndjeu dorën e tij tamam mbi dorën e saj, - prit edhe pak, ja, sa të ngjisim këtë të përpjetë të vogël.

Përpara syve të saj, tamam midis lulishtes së trotuarit dhe majës së malit të lartë, doli një hotel i madh me shumë kate dhe tepër i bukur. Lukrecia puliti sytë dhe pyeti si një fëmijë :

-Edhe kjo është Peshkopia ?

-Po. Kjo është Peshkopia e re, qyteti i ri i Peshkopisë. E di ti se ky është i vetmi hotel në tërë veriun e Shqipërisë? Vjet, në dimër, bëra një shërbim të gjatë për një temë të lirë: jeta qytetare. Një herë tjetër do të tregoj peripecitë e atij udhëtimit të vështirë. Tani do të të them me dy fjalë se kur më në fund u futa në këtë hotel, e ndjeva veten se kisha gjetur oazin e ëndërruar të atyre ditëve dhe njëkohësisht konkretizova temën për të cilën isha nisur. Shkrova një reportazh të gjatë për jetën e hoteleve, si ai i Pukës, që i ngjante një hani, ai i Kukësit të vjetër, që të ngjallte në shpirt ndjenjën e një objekti që po vdes, ai i Kurbneshit që të kujtonte shtëpinë. Përgjegjësi i hotelit për shembull, të hynte pa të keq në dhomë e të vinte te koka filxhanin e kafesë sapo dëgjonte se ishte zgjuar. Në Tropojë qe pak më ndryshe. Sa të hyje në klub, ose në restorant të hotelit të vinin në tavolinë gotat e rakisë ose të birrës nga vendasit, të cilët e quanin për nder të qerasin mysafirin pavarësisht se s'të njihnin. Në Shën Mëri, për shembull ishte dhe më interesante. Atje s'kishte hotel, po edhe

kishte. Udhëtarin, që e zinte nata e strehonin në dy-tri dhoma të kapanoneve të punëtorëve. Roja i natës, që përgjigjej për kapanonet, të ndizte zjarrin, të mbante me muhabet deri sa të kuptonte se po të mbylleshin sytë. Dhe në mëngjes të sillte peshqirin e të shtinte ujë për të larë sytë, të bënte dhe çaj e të shoqëronte deri në menci e, pa të pyetur fuste kokën në sportel, çof bisedonte me guzhinierin e të sillte pjatën me pilaf ose fasule. Dhe ti largohesh nga Shën Mëria e Kukësit me emrin e një njeriu që t'u bë mik brenda një nate.

-O, Sifi, ti më the gjithë këto gjëra që unë të harroj lokalitetin, si e kishte emrin ai lokalitet ?

-Ç'e do ? Më mirë kur nuk ia di emrin. E harron më shpejt.

-Ti s'ke ndërmend të ma thuash se ç'bisedova me ata dy burrat te dera e klubit? Ata të folën për mua, apo jo ?

-Të thashë një herë, ata m'u lutën që të jepnim sonte shfaqje tek ata.

Lukrecia qeshi hidhur, po në shpirt nuk e kishte më atë shije pelini.

Të dy zbritën të fundit nga autobusi dhe ngjiten me nxitim shkallët e hotelit.

-Në hotelin tonë, - dëgjuan që po thoshte përgjegjësi, - do të gjeni gjithçka. Dhe restorant, dhe bufë, dhe pistë vallëzimi, dhe verandë ku mund t'ju shërbejnë pije freskuese, kafë dhe ëmbëlsira. Besoj se do të mbeteni të kënaqur.

-Po dush keni? - pyeti Lukrecia.

-Po, edhe dush. E përgatisim zakonisht vetëm kur porosisin klientët. Kur të zini dhomën, i thoni sportelistit dhe ai ka për të urdhëruar që t'jua bëjnë gati.

Dhoma ku zuri vend Lukrecia kish dritare me ballkon nga jugu. E gjithë dhoma ishte rregulluar aq bukur dhe ish aq e pastër sa Lukrecias s'i dilej s'andejmi. Shtrati ish i gjerë dhe i mbuluar me një kuvertë të hollë bojë limoni.

Lukrecia hapi valixhen dhe filloi të nxjerrë s'andejmi rrobat e t'i vendoste në dollap. Në këtë kohë trokiti dera, Lukrecia ngriti kokën dhe thirri :

-Hyr!

Dera kërciti dhe u hap pak. Një kokë gruaje u zgjat brenda në dhomë.

-Hyni, hyni, - e ftoi Lukrecia gruan dhe nuk po kuptonte se ç'ishte kjo e panjohur : nuse apo vajzë dhe ç'hall kishte megjithë atë ndrojtje. Veç një gjë ishte e dukëshmenë tërë qënien e saj : kurioziteti. Sytë e saj sikur po shihnin një çudi. Lukrecia e ndjeu veten të fyer nga ai vështrim dhe menjëherë mbajti qëndrim.

Gruaja e ndjeu dhe e pa të udhës të fliste sa më parë.

-Jam pastruesja e hotelit, erdha t'ju them se banja është gati.

Pres t'ju çoj deri tek banja. Është në krahun e djathtë, dera e fundit.

-Po pse jeni kaq e ndrojtur ? - pyeti Lukrecia.

Ajo s'u përgjegj.

-Kur keni hyrë në punë ?

-Ja, s'ka dy muaj, pas martesës, im shoq punon poshtë, në restorant, - shtoi gruaja dhe sapo u çlirua nga ndrojtja filloi sërish të vështrojë me çudi Lukrecian.

-Ja, dhe unë u bëra gati, - tha pas pak Lukrecia, - tashti mund të shkojmë.

-Desha t'ju them dhe një gjë, - tha gruaja, - im shoq m'u lut t'ju them për nja dy bileta, se ç'thonë për atë shfaqjen tuaj...

Lukrecia ktheu kokën me rrëmbim, aq sa flokët u rrotulluan dhe i mbuluan fytyrën.

-Çfarë thonë? - pyeti Lukrecia, duke zbuluar fytyrën e duke u munduar ti mbante me dorë që të lironte sytë.

Pastruesja e hotelit u skuq më shumë se bluza e kuqe me pika të verdha. Ajo mblodhi supet, si të ishte fajtores dhe i fshehu sytë.

Kafeneja, veranda, trotuari dhe rruga para hotelit zjerin. Njerëzit ishin grumbulluar nga katër anët e qytetit dhe kërkonin bileta për shfaqjen.

Kur doli Lukrecia përjashta, u habit. Si e hutuar kaloi midis njerëzve që vinin vërdallë nëpër verandë, që hynin e dilnin sa në kafene, në restorant dhe që i hapnin rrugë, duke e përpirë me sy.

Lukrecia dëgjoji që ë thirrën dhe ktheu kokën.

-Po ti, - i tha ajo kur pa Josifin, - ç'bën ketu, në këtë pazar biletash ?

Ai nuk iu përgjigj.

-Ç'ka ndodhur, Josif ?

Josifi mblodhi supet si të ishte dhe ai shkaktari i atij elektrizimi.

-Ç'keni që mblidhni të gjithë supet? Çka ndodhur, po të pyes?

Josifi e kapi për dore, si për t'i treguar të gjithëve se ai ishte njeriu më i afërt i saj dhe e tërhoqi deri brenda në lokal, duke e shpëtuar nga vështrimet kurreshtare.

-E di se këtu ka ardhur para nesh jehona e shfaqjes?

-Po të ishte vetëm jehona e shfaqjes, do të më bëhej shumë qejfi. Më duket se bashkë me jehonën këtu ka ardhur dhe ai vështrim prej ujku i atij policit të lokalitetit. Nuk e vë re se si më shikojnë?

-Ashtu siç të shoh dhe unë, me adhurim. Do të të them se të dua ? E? Pse më vështron ashtu sikur nuk më beson ? Qenke larë ?

Lukrecia pohoi si e hutuar. Ajo e kishte mendjen te pyetja e parë "Do të të them se të dua, ë?" Nuk e priste kurrë që Josifi do t'ia shfaqte me pikëpyetje dashurinë, si të thuash indirekt. Kjo gjë e hutoi aq shumë, sa ajo pothuajse, nuk e dëgjoji pëshpëritjen e Josifit : -Po

të ishim vetëm do të të puthja.

Nga që s'qe e sigurtë se u thanë ato fjalë, e pyeti :

-Çfarë the ? Sikur s'të dëgjova mirë.

-Deri tani të kam thënë tri gjëra : se të dua, se qenke larë dhe se po të ishim vetëm do të të puthja.

-Mos ke dëshirë të më thuash dhe ndonjë gjë tjetër? - pyeti

Lukrecia.

-Po.Dua të të pyes për shoket e tu, të grupit teatral.

-Besoj se do të jetë një pyetje e çuditshme, - tha Lukrecia, e cila u çudit. Pyetja e fundit, e katërta, iu duk më e rëndësishme.

-Ç'je ti për ata. Thjesht një shoqe e grupit teatral, apo një motër? Bile dhe Shkëlzeni, shoku im, se ç'mban një qëndrim tjetër. Sikur ka një lloj frike nga unë, nga afrimi ynë, sikur trembet..

-Edhe shoqe, edhe motër, - u përgjigj Lukrecia, sytë e së cilës u bushën me lot.

-Atëhere, mos vallë duhet t'u them dhe atyre atë që të thashë në fillim ?

-Meqë Shkëlzenin e paske kaq shok, nuk do të ishte keq të bisedoje dhe me të. Ai mund të të thotë ca gjëra, që mua mbase më vjen zor t'i them.

Josifi kapi në tonin e zërit të saj një note të dhimbshme e të trishtueshme dhe në bebëzat e syve një hon.

-Mua më vjen çudi, - vazhdoi Josifi. - Unë s'besoj që dashuria lind me vështrimin e parë, po, kur të pashë në hidrocentralin e Shkopetit ndjeva diçka; sigurisht ajo që ndjeva atëhere ishte diçka e papërcaktuar, po ishte ama, bile ajo më shtyu që të hipja në makinë dhe gjatë gjithë rrugës ajo ndjenjë herë forcohej, herë zhdukej fare. Në ato çaste vendosja të zbrisja, po makina ecte. Atëhere unë mendoja për ty, bile të vëshetroja vjedhurazi dhe gjithnjë më dukej sikur unë të njihja prej kohësh.

-Çudi, - pëshpëriti Lukrecia, - unë paskam qenë fare

budallaqe, s'paskam kuptuar asgjë ngandjenjat e tua, bile unë të mora inat kur kërcyem në pistën e Burrelit, kurse ti...

Josifi qeshi, Lukrecia mori frymë thellë e vazhdoi : -Pastaj unë e harrova fare mërinë, ti se si hyre te unë dhe s'më le të mendoj asgjë tjetër. Çdo mendim që më vinte në kokë niste me ty , sikur të ishe ulur këmbë kryq në mëndjen time dhe rrinje pa të keq si të ishe në shtëpinë tënde. Në fillim kjo gjë më nevrkoste. Atëhere kujtoja gjëra të shkuara, të ndodhura shumë kohë para se të njiheshim dhe, për çudi , ti sikur kishe vendin tënd, sikur ne të ishim njohur që të vegjël.

-Ç'urdhëroni , - tha papandehur kamarieri.

-Gjërat më të mira që kini na i sill këtu, - tha Josifi.

-Të parë, të dytë, të tretë, - filloi të numërojë kamarieri.

-Në qoftë se keni dhe të katërt e të pestë, sillnani, - tha përsëri

Josifi.

-Më falni, - iu drejtua Lukrecia kamarierit, mos vallë gruaja juaj punon sipër ?

-Po, - tha kamarieri.

-Ajo më porositi për dy bileta, udhëroni, - tha Lukrecia dhe ia zgjati.

Kamarieri u skuq njëllloj si eshoqja në dhomën e Lukrecias.

Pas pak ai solli një shishe me verë të vjetër.

-Pa këtë stoli, tavolina do të dukej e zbrazët, - tha dhe u largua.

-Pastaj? - ngriti zërin Josifi si për ta përmendur Lukrecian, e cila u hutua nga pyetja dhe sikur u tremb.

Honi bosh në sytë e Lukrecias ishte tretur. Si me magji aty sikur kishte mbirë një lëndinë.

-Mos vallë fjalët janë të tepërta? - pyeti Lukrecia.

-S'do të flisja vetëm po të kisha mundësi të të puthja,- pëshpëriti Josifi me frikë se mos fjalët e tij kapërcenin tavolinën e

tyre deri te tavolina fqinje.

Ajo frikë e vogël nuk i pëlqeu Lukrecias, megjithatë ajo e pa me dashuri dhe i erdhi shumë mirë që pa po atë dashuri dhe në sytë e tij. Nga mesi i bukës ajo e ndjeu të nevojshme dhe tha : - megjithatë ne duhet të flasim.

* * *

Kur filloi të hapej perdja në sallë ra qetësi. Dhe ajri sikur u elektrizua. Josifi, ndonëse e kish parë shfaqjen në Burel e Bulqizë, ndjeu një farë frike dhe ndrojtje. Ai u çudit nga kjo ndjenjë dhe ngadalë e kuptoi se gjithë ndrojtja e tij ishte vetëm për Lukrecian.

Në skenë aktorët filluan të ngrejné kurthin për fajdexhiun koprac. Këtë radhë Josifit po i dukej pjesa më e arsyeshme, bile, ajo filloi ta tërheqë, t'i pëlqejë dhe ta bëjë të qeshë.

Në skenën e dytë doli Lukrecia e veshur si shërbëtore. E qeshura e saj tingëlloi nëpër skenë e ëmbël, e ngrohtë, dehëse dhe, sa herë që i zoti i hotelit përpiquej t'i mbushte mendjen se gjoja ajo ish e shoqja dhe jo shërbëtorja, Lukrecia shpërthente me të qeshura. Hotelxhiu sërish i fliste e i thoshte se duhej të shtirej si e rënë në dashuri me kopracin që pritej të vinte në hotel. Ajo, duke luajtur mrekullisht rolin, gjasme ishte e shoqja e hotelxhiut, shpërthente në atë të qeshurën e saj ngjitesë, aq sa dhe spektatorët nisën të qeshin bashkë me të.

Në skenë hyri kopraci. Ai ish i pashëm dhe i ri, s'ish siç janë në përgjithësi kopracët : pleq e të shëmtuar. Lukrecia doli në dritaren e hotelit dhe e ftoi. Kopraci dhe publiku panë gjoksin e saj të plotë e të bardhë. Kopraci kapërceu pragun dhe hyri në hotel, si miu në çark.

Duke u mbyllur sipari Josifit sërish i rrahu zemra. Ajo i rrahu edhe më shumë kur, pas pak, u hap perdja dhe doli një dhomë e thjeshtë hoteli, e ngarkuar rëndë me mobilje të shekullit të shkuar.

Kopraci dhe ajo, përballë njëri-tjetrit, bënin deklarata dashurie. Në sytë, gjestet dhe në zërin e kopracit kushdo ndjente se si ai, me fjalë të ëmbla e të buta dashurie, fshihte dhelpërinë e ligësinë, fshihte një shpirt të zi katran e të ftohtë si gjarpër sa të ngjetheshin mishrat, kurse ajo, Lukrecia, ligjëronte si një zog. Të gjithë shtangën, sepse të gjithë e dinin që nga skena e mëparshme, se ajo duhej të shtirej si e rënë në dashuri, duhej të luante me dashurinë, të tallej, ta ndillte atë si macja riuun, kurse ajo ra në gjunjë dhe, sikur të kish përpara jo një djall, po një engjëll, filloi të qajë. Ajo e harroi pjesën e saj, harroi se si duhej të luante, se ç'tingull duhej t'u jepte fjalëve. Ajo shpërtheu, duke mbushur skenën e sallën plot me dashuri. Sikur të kish pritur vite me radhë ardhjen e tij në këtë dhomë, Lukrecia u bë si e marrë saqë s'dinte ç'të fliste, s'donte ç'të bënte që ai të besonte se në atë dhomë të vogël ish mbret, mbret i të gjitha sendevë dhe i asaj, po, dhe i asaj, dhe, si tha fjalën e fundit të dashurisë, zbërtheu kopsën e parë të këmishës së hollë e transparente, pastaj ndjeu t'i dridhen duart, po prapë mundi dhe zbërtheu kopsën e dytë dhe guxoi të ngrejë kokën. Ai u afrua, zgjati duart, e kapi dhe e afroi për ta puthur. Atë çast ajo duhej të kundërshtonte, të bërtiste që ta dëgjonte i shoqi, ta dëgjonin borxhlinjtë e qytetit, kurse ajo, si e hutuar, heshti dhe i la buzët e lira, pak të zgjatura. Megjithëse ajo nuk thërriti ndihmë, në dhomë u sulën borxhlinjtë dhe hotelxhiu dhe e shqitën kopracin nga trupi i saj dhe, duke e rrahur e përzunë nga hoteli, pastaj nga qyteti, e kështu, shpëtuan nga borxhet.

Publiku duartrokiti për të përshëndetur aktorët e ardhur nga kryeqyteti. Perdja u hap përsëri, duartrokitjet u shtuan. Aktorët përkulnin ngadalë kryet në shenjë falenderimi dhe buzëqeshnin. Duartrokitjet u shtuan, siç duket publiku kërkonte Lukrecian, e cila s'ish midis trupës. Regjisori u largua nga shokët dhe pas pak doli përsëri në skenë duke tërhequr pas dore Lukrecian. Ajo ish po aq e bukur sa në finalen e pjesës. Josifit iu duk sikur ajo kish qarë, po

perdja u mbyll sakaq dhe ai s'e pa më

Josifi mundohej të dilte sa më parë nga salla, por njerëzit ecnin ngadalë, me nge e duke kuvenduar. Kur më së fundi doli, derën e pasme, që komunikonte me skenën, e gjeti të mbyllur. Rojtari i tha se ata kishin dalë të gjithë, i fundit kishte dalë regjisor, bashkë me Lukrecian.

-Nesër do të japin përsëri shfaqje, - shtoi rojtari si për ta qetësuar.

Josifi u largua menjëherë dhe e kërkoi Lukrecian kudo, në kafe, në restorant po s'e gjeti kurkund. Sportelisti i hotelit i tha se ajo kishte më se gjysme ore që kishte marrë çelsin. Pa mbaruar mirë fjalën sportelisti, Josifi ngjiti shkallët dhe u gjend përballë derës së saj.

Trokiti ngadalë dhe, pa dëgjuar t'i thonë hyr, hapi derën. Ajo qe pranë dritares. Ktheu vetëm kokën. Sytë e saj ishin tërë lot.

Josifi mbylli derën dhe iu afrua. Ajo vetëm u mbështet tek ai dhe psherëtiu.

-Asnjëherë në jetën time s'më ka ndodhur kështu. unë s'e shikoja fare kopracin, në vend të tij më dukej se ishte ti. Duhet të jem një budallaçkë.

-Ti ke luajtur në mënyrë të shkëlqyer, Lukrecia.

-Jo, unë sonte s'kam luajtur, unë sonte kam jetuar, kam ndjerë si asnjëherë dashuri, një dashuri të vërtetë, kam qenë aq e lumtur sa hërrova fare se jam në skenë, në Peshkopi dhe tashti më ngjan se jam në ëndërr.

-Edhe unë, - tha Josifi dhe ndjeu tërë trupin e saj t'i bjerë si nga qielli në krahë. Gjoksi i tij u puthit me gjoksin e saj. Josifi ngriti pa dashje kokën, rrëshqiti lehtëzi faqen pas faqes së saj dhe ashtu, si kot, zgjati buzët dhe u elektrizua kur puqi në buzët e saj, në ato buzë që atij i kishin mbetur në mendje në skenën kur ajo i zgjati drejt buzëve të kopracit. Megjithëse epshi qe i fortë, marramendës, ai ndjeu se kjo e puthur nuk i ngjante fare asaj puthjeje të natës së shkuar në hijen

e hënës, pas shëlgjishtes së fushës së Vajkalit. Mbrëmë një natë më parë, ajo, Lukrecia, ishte e lehtë, pupël, kurse sonte në krahët e tij ajo ishte e rëndë, ishte prej mishi dhe e përhumbur, sikur s'kishte këmbë që ta mbanin. Josifi e uli ngadalë në shtratin mbi kuvertën bojë limoni. Ajo, duke u rrëzuar, e tërhoqi me vete.

Duart e Josifit, çuditërisht të qeta, u futën në gjoksin e saj. Ajo perëndoi sytë. Symbyllur u duk dhe më e bukur, krejt e përhumbur, si e përgjumur ajo kishte harruar gjithçka aq sa nuk reagonte ndaj lëvizjeve të duarve të Josifit që shëtisnin të etura në trupin e saj, gjithë dyshim në se gjithë ç'po përkëdhelte, gjinj, bel, kofshë, bark, shpinë e sërish gjinj ishin të tijat, ishin në duart e tij. E pengonte për t'u bindur plotësisht vetëm fustani. Kur ia hoqi, u hutua, si ndodhi kjo çudi? Si është e mundur që ajo bukuri, elegancë, brishtësi gati e pakapshme, të cilën mundi ta shijonte vetëm për pak çaste në fushën e Vajkalit tani të ndodhej nën peshën e trupit të tij, nën duart e tij? Dhe ajo s'bëri asnjë kundërshtim, asnjë lëvizje proteste. Të dy u tretën e humbën në atë magji joshëse. Josifi u përmend i pari. Gishtërinjtë e tij, si venduzat e një oktapodi, u çkontraktuan. Pëllëmba e dorës mbi gjirin e saj lëvizi lehtë, sikur kërkonte në errësirë diçka që i kishte humbur. Dora u drodh dhe ashtu, rrëshqanthi, kaloi te gjiri tjetër. Ai gjoks nuk e kishte me atë bukuri, freski e magji joshëse: të skenës në dritaren e hotelit të Kopehanges, kur u përkul para kopracit dhe spektatorëve. Ai gjoks s'kishte asgjë vajzërore. Ishte tepër i butë, si brumi, si qull. Josifit iu drodh dora sërish e sërish rrëshqiti te beli, te lëkura e barkut dhe sërish u rrënqeth, që s'gjeti as aty vajzëri.

Lukrecia e përhumbur lëvizi. Ngadalë nisi të hapë sytë. O, asnjë lule nuk mund të çelë në një mëngjes me vesë më bukur se sa po përpëliteshin qepallat e saj, deri sa zbuluan dy sy që ndritnin e vezullonin lumtërisht, aq të dashur, aq njerëzorë, aq të lumtur.

Josifi lëvizi mbi trupin e saj. Lukrecia u tremb se mos trupi

që rëndonte mbi trupin e saj do të ngrihej. Ajo qeshi dhe tha :

-Aty rri. S'të pëlqen të rri sh aty?

"Tërë jetën", i tha vetvetes Josifi. Po, ajo ishte përgjigja më e saktë, më e ndjerë, veç buzët, si të ishin të pavarura nga ai, nuk thanë atë që duhej të thoshnin atë çast. Ato, për të mbuluar atë të vërtetë, u shtirën si të etura dhe u mbështetën mbi buzët e saj. Po puthja që e ftohtë.

Josifit i kaloi një mornicë nëpër trup. Lukrecia e ndjeu.

-Ç'pate?

-Nuk e di se si më erdhi, - tha ai dhe u mundua të buzëqeshte.

E puthi sërish për të mbuluar të puthurën e ftohtë që dhanë pak më parë buzët.

Lukrecia mbylli sytë. Atë çast ai mendoi se, sa herë që të donte do t'i telefononte asaj nga zyra e tij e do t'i linte takim. Josifi e ndjeu veten zot mbi trupin e saj lakuriq.

"Kjo tani është imja", tha Josifi, u ngrit dhe i la në ajër dy krahët e saj që u përpoqën ta mbanin.

Lukrecia psherëtiu.

-Ç'ke, Lukrecia ?

-Asgjë, më vjen keq që të njoha kaq vonë, - pëshpëriti ajo.

-Ç'flet Lukrecia !

-S'besoja kurrë se një ditë do ta ndjeja sërish dashurinë. O, Sifi, që të jem e denjë për ty duhet të të them gjithçka... çdo gjë që ka ndodhur me mua.

Josifi ia mbylli gojën me një të puthur të gjatë dhe, si u mbush me frymë, i pëshpëriti :

-Asgjë s'dua të di. Mua më mjaftojnë vetëm këto dy buzë dhe këta dy sy, - shtoi dhe ia puthi lehtë dhe buzët dhe sytë.

Lukrecia, me sy mbyllur foli si e përgjumur :

-Megjithatë ti, para se të vendosësh, duhet të më sosh se...

-O, - bëri sikur rënkoj Josifi dhe, ndonëse donte vërtetë të dinte

gjithçka nga jeta e saj, u çudit kur dëgjoi zërin e tij : - E lemë këtë muhabet, Lukrecia! Ka shumë vajza në botë, që kanë qejf të rrefehen kur bien në dashuri.

-Unë s'jam në botë, Sifi! Jam këtu, në Shqipëri. E di ti çdo të thotë të jesh vajzë në Shqipëri ?

-Regjisori dhe Shkëlzeni më folën për ty, më thanë gjithçka. Nuk di pse m'i thanë dhe pse të dy. M'u duk sikur gjithë trupa teatrale kish bërë mbledhje dhe se ata të dy ishin të deleguar për të bërë biografinë tënde.

-Kur kështu ? - u nxehtë Lukrecia.

-Pas shfaqjes. Ata flisnin me radhë, tamam sikur të ishin të përgatitur. Mos vallë kishin qëllim që unë, para se të vija sonte në këtë dhomë, të mendohesha mirë ?

Lukrecia qeshi hidhur, aq sa Josifit iu dhimbs. Duke parë sytë e përlotur të saj, ai u kujtua se ishte në hotel, se kishte hyrë fshehurazi në dhomën e një femre e se ashtu, lakuriq e pranë njëritjetrit nuk i shikonte vetëm hëna tej dritares, po dhe yjet, mbase dhe dikush tjetër... nga ata që e kishin parë në shelgishten e fushës së Vajkalit e që pa gdhirë e kishin çuar fjalën deri në atë lokalitet buzë luginës.

-Mos u mërzit nga fjalët e tyre. Ata ashtu e kanë. Nuk është as punë xhelozie.

-Për mua ka rëndësi që të dua, - tha Josifi dhe u çudit nga deklarata e tij, të cilën ai e ndjeu se ishte e vërtetë, po ndjeu gjithashtu se ato fjalë i tha , si për të mbrojtur vetveten dhe u çudit që pa si me frikë edhe hënën edhe yjet.

Lukrecia nuk iu përgjigj. Ajo zgjati sërish krahët dhe e tërhoqi pranë vetes. Josifi ndjeu se si i rrihte zemra në kraharor, ndjeu qepallat e syve të saj në fytyrën e tij, pastaj ndjeu lotët e saj të ngrohtë t'i rrëshqisnin në faqen e tij dhe e puthi me një mall të atillë sa s'e kish ndjerë kurrë.

Në dhomë, nga që hëna qe ngritur lart, hija e plepit qe zhdukur. Drita e saj ra mbi trupat e tyre lakuriq. Josifi zgjati dorën, tërhoqi çarçafin dhe u mbulua. Paspak ai nxorri dorën mbi çarçaf dhe mbuloi edhe Lukrecian.

Në mëngjes dielli mbushi me dritë dhomën dhe përzuri gjumin.

Josifi u habit kur pa orën.

-Sa është, - pyeti Lukrecia, duke i nxjerrë krahët jashtë çarçafit të bardhë.

-Ata do të jenë nisur për në llixhat - tha Josifi, - ora është tetë e gjysmë.

-Aq më mirë atëhere, do të rrimë bashkë gjer sa të kthehen.

Mëngjesin e hëngrën në një lokal të pjesës së vjetër të qytetit, tek një qoftexhi.

Duke ngrënë Josifi dhe Lukrecia dëgjuan të pëshpëritej :

-Ç'ta ketë atë?

-Sigurisht burrë. Ndryshes'ka sesi të vijë këtu e të hajë qofte.

-Çudi pra, të isha unë si ai s'e lija të hargalisej ashtu e t'i ngjitej atij kopracit si rrodhe.

-Kurse unë s'e lija të luante teatër.

Josifi dhe Lukrecia qeshën nën buzë dhe ia bënë me sy njeri tjetrit.

-Sikur ata ta dinë se ne s'jemi burrë e grua, - i pëshpëriti Lukrecia Josifit, - ç'do të thonë?

-Nuk më intereson, - tha ftohtë Josifi dhe me vete mendoi se ç'mund të thoshin vërtet sikur ta dinin që ata s'ishin burrë e grua, ose më tepër akoma, sikur ta dinin ata jetën e saj, që ajo kish qenë njëherë gruaja e dikuj e se tashti, me mua bën dashuri pa teklif, ha qofte dhe qesh e bën si i do qejfi në skenë ?

Lukrecia, duke ngrënë, vuri re Josifin dhe ndjeu se ai sikur kishte rënë në mendime. Ajo u mat ta pyeste, po s'guxoi. Josifit i kish

rënë në fytyrë një hije e rëndë.

"Ç'mendon vallë" - tha me vete Lukrecia dhe ndjeu se s'kish më dëshirë të hante.

-S'të pëlqejnë? - pyeti Josifi kur pa se ajo e largoi pjatën me qoftet që avullonin.

-U ngopa, - tha Lukrecia dhe e vështroi në sy.

Ai iu shmang vështrimit të saj.

-Shkojmë atëhere, - tha Josifi me të shpejtë, sikur ta kish pritur prej kohe këtë çast.

- Lukrecia vuri re se në rrugë ai ndryshoi përmjeherësh. Atëhere ajo u bind se qenë fjalët e atyre që e kish shtënë në mendime.

-Lukrecia, - nisi të flasë Josifi.

Ajo ngriti kokën dhe pa sytë e tij që ishin qetësuar.

-A dalim jashtë qytetit ?

-Dalim, - tha Lukrecia.

Sa kaluan urën, fill pas kthesës së parë, Josifi guxoi dhe e kapi për dore dhe ashtu vazhduan të ecnin të heshtur e të menduar.

* * *

Kur u kthyen dhe kur Lukrecia hyri në dhomën e saj e kuptoi pse Josifi i kish thënë që të dilnin jashtë qytetit, sapo kishin dalë nga qoftexhiu.

Ajo kuptoi që Josifit s'i erdhi mirë kur ata pëshpëritën për të.

Dhe Josifi u mbyll në dhomën e tij. Ai ishte trishuar nga thashethemet që ishin përhapur e nga mënyra se si ishin përhapur .

Në fillim fjala doli nga hoteli, doli në mënyrën më sekrete ; roja i natës i pëshpëriti në vesh sportelistit, sportelisti kamarierit të restorantit në katin e parë dhe ky, po në mënyrë sekrete, u pëshpëriti me radhë gjithë klientëve që hanin mëngjes. Kaq u desh dhe fjala u përhap si të ish erë. Në mënyrën më të çuditshme u mësua nga të

gjithë edhe biografia e saj.

Qyteti i tërë u gjallërua sikur të ish prekur në sedër, megjithatë biletat u shitën më shumë se natën e parë. Kasieri i shtëpisë së kulturës dhe krijimtarisë popullore tha se biletat, ishin shitur pa autorizim dhe se sekretari i Komitetit Ekzekutiv, që mbulonte kulturën, i kishte thënë me zë të lartë, në mes të kafenesë, që ai kishte rezerva ndaj shfaqjes e aktorese, e cila e kishte kthyer hotelin në bordell dhe s'mbantë përgjegjësi.

Kur ra mbrëmja qendra e qytetit u bë përsëri shesh përpara hotelit dhe shtëpisë së kulturës. Njerëzit e ngeshëm rrinin në këmbë duke pirë duhan e duke bërë muhabet, ndërsa trupa e vogël teatrale ishte lart, në hotel dhe s'dinte se ç'të bënte.

-Do të dalim ta gjithë bashkë, - tha regjisori duke parë orën, pastaj pa nga dritarja turmën e kureshtarëve. Atij iu duk se s'kish parë kurrë në jetën e tij kaq njerëz të grumbulluar.

-Gati, - thirri regjisori si për t'u dhënë zemër.

-Gati, - tha Lukrecia.

Të gjithë shtangën nga zëri i saj. Ajo e tha fjalën me një emocion të atillë si të ish pas perdes që do të hapej në çast.

-Ne nuk duhet të shqetësohemi, - tha regjisori, - shfaqjen do ta japim me qetësinë më të madhe, pa ua vënë veshin thashethemeve do ta japim shfaqjen gjer në fund, edhe sikur të na fërshëllejné.

-Ndërsa unë e them edhe një herë se pa zgjidhur çështjen e Lukrecias ne s'mund të japim shfaqje, ne vimë këtu që me punën tonë të edukojmë masat, kurse kjo... - nisi të flasë një nga aktorët.

-Mjaft, - udhëroi regjisori, - çështjen e Lukrecias e bisedojmë në Tiranë.

Dikush hapi dritaren. Në dhomë hynë zërat e turmës.

-Dalim se u vonuam, - tha regjisori dhe doli i pari.

Lukrecia u zbeh dhe ndjeu zemrën t'i rrahë me forcë. Asaj

iu duk sikur do të dilte në një skenë gjigande, në një rrugë të madhe e të gjatë, plot drita e njerëz e se atje duhet të luante një rol tepër të vështirë, ajo duhej të ecte gjer në fund të asaj rruge dhe folur, vetëm nga mënyra se si do të ecte, ajo duhej t'u thosh spektatorëve kuriozë se dashuron, dashuron me gjithë forcën e shpirtit të saj të pastër e se të flesh me atë që do nuk është krim.

Me këto mendime Lukrecia doli në rrugë në fund të trupës së vogël dhe ndjeu përnjëherësh peshën e rëndë të vështrimit të turmës. Lukrecia ngriti kokën dhe pa dritat e shtëpisë së kulturës dhe ato iu dukën shumë larg, megjithse nuk ishin as pesëdhjetë hapa. "Do të numëroj që të jem e qetë", - foli me vete dhe numëroi, po numrat iu ngatërruan. Atëhere ajo përmbloodhi veten dhe duke ecur kujtoi se ç'i kish ndodhur në hotel. Ngadalë, ajo ktheu kokën majtas dhe pa kureshtarët që e vështronin. Mori frymë thellë dhe filloi të ecë gjoja e shkujdesur, si për t'u lënë të kuptonin të gjithëve se ajo që ndodhi mbrëmë do të ndodhë dhe sonte, dhe nesër...Duke ecur, e duke vështruar vjedhurazi, duke ndjerë vështrimet e duke u përpjekur t'i mposhtë ato, Lukrecia u lodh. Me mundim ngriti kokën lart dhe pa përsëri shtëpinë e kulturës. Ajo përsëri iu duk larg, megjithse tani ajo ishte midis njerëzve, aty në shesh, para teatrit. Nuk i kishin mbetur veçse hapat e fundit.

"-Ç'është kështu!" - tha me vete duke ndjerë t'i mbushën sytë me lot. Roli, që i kish caktuar vetes, dhe që e kish luajtur aq bukur gjatë gjithë rrugës, e lodhi tashti, iu duk se s'mund të vazhdonte më. Lukrecia qëndroi, qëndroi vetëm një sekondë dhe pa se populli shtyhej për të hyrë në sallë.

Lukrecia bëri edhe disa hapa dhe hyri brenda. Në sallë mbante era duhan. Ajo kaloi anash, ngjiti ato tri shkallët dhe hipi në atë korridor të ngushtë dhe u fut në dhomën e grimit, në derën e dytë djathtas, e mbylli nga brenda dhe u ul si e këputur, sikur të kishte bërë një marshim të gjatë zbori ushtarak. Zuri kokën me duar dhe u

mbështet mbi dy bërrylat para pasqyrës, po me sy mbyllur. Kur i hapi sytë pa veten aty në pasqyrën e madhe. Ishte ajo vetë, veç pikë gjaku në fytyrë. Sytë e saj, si të ishin sytë e një vajze tjetër, u ulën te kutiçkat me krem e pudër, te kalemrat me ngjyrë aty para duarve të saja që u shtrinë përpara. Dhe në pasqyrë, në perspektivën që krijonte ajo, ishin duart e saj dhe gjithë ato sende me të cilat ajo mund t'i jepte ngjyrë fytyrës, mund të zhdukte ato dy vijëza si brazda në ballë dhe ato vijëza të holla në cep të syve, edhe atë vijë të prerë që ndehej anash buzëve. Ajo pa me kujdes dhe zbuloi se atë vijëzë nuk e kish patur dje.

Një e trokitur lehtë në derë. Lukrecia u tremb. U tremb dhe më shumë kur dëgjoi zërin e regjisorit :

-Zoica, aty je ?

-Po.

-Mirë je?

-Po.

-Fillove të vishesh ?

-Po, - gënjeu dhe u shkëput nga vetvetja në pasqyrë. Duke ecur drejt rrobave ajo pa sërish në pasqyrë një vajzë që ngjante si dy pika uji me të. Dhe ajo ecte drejt garderobës, kanatat e së cilës kishin mbetur të hapura që mbrëmë. Në kremastar pa rrobat e shfaqjes, fustani i bardhë dhe jeleku i aktit të parë, këmisha e hollë e natës dhe kapuçi i aktit të dytë. Dhe në pasqyrat e dy kanateve të dollapit Lukrecia ose Zoica pa sërish atë vajzë që i ngjante dhe ndiqte në çdo hap, në çdo lëvizje duke e imituar në mënyrën më të përsosur. Lukrecia e pa me habi. Dhe ajo, në pasqyrë, ia ktheu habinë.

"Pa të shohim çdo të bësh tani?" - e pyeti Lukrecia shëmbëlltyrën e saj në pasqyrë. Shëmbëlltyra lëvizi vetëm buzët, e imitoi, po zë nuk nxorri.

Lukrecia u përkul fare pak dhe kapi dy cepat e fustanit të saj,

-S'guxova të vija, Lukrecia, po kjo s'do të thotë se s'të dua.

Lukrecia pëmjëherësh ndjeu një boshllëk të madh, një zbrazësirë të tmerrshme në shpirt, tamam sikur pa pritur të ish ndodhur në mes të një qyteti gjysmë të rrënuar e pa njerëz. Kur Josifi tha fjalën e tij të fundit, ajo ngriti kokën e trembur se në çast iu duk sikur dhe ai e la dhe u zhduk në gërmadhat e qytetit.

-Ç'ke Lukrecia, s'je mirë? - pyeti Josifi.

-S'kam gjë jo, se si më erdhi, - tha ajo dhe u mundua t'i buzëqeshë.

Josifit i erdhi keq kur pa sytë e saj gati të përbotur dhe u tremb se mos ajo do të qante. Ktheu kokën sa majtas djathtas me frikë se mos vallë i vështrojnë, po në çast ngriu, sepse Lukrecia qeshi me zë të lartë.

-Sa frikacak qenke, si fëmijë i vogël!

-Lukrecia, - protestoi i ofenduar Josifi, - ç'flet kështu?

-Asgjë, i dashur, mos ma vër re, nuk thashë ndonjë gjë të madhe, fundja të krahasova me një fëmijë dhe jo me ndonjë... siç duan të më krahasojnë mua, sepse guxova dhe fjeta me ty një natë.

Josifi u zverdh. Atij s'i kish qëlluar kurrë në jetën e tij të ngatërrohej me një femër në një mënyrë të tillë e të bisedonte kaq hapur. Megjithse ajo bëri vetëm aluzion për ta krahasuar veten e saj me një kurvë, Josifit iu duk sikur ajo e tha.

-Ç'ke që u zverdhe, - pyeti e habitur Lukrecia, -ç'të shqetëson.

-Jo, asgjë, - tha ftohtë Josifi dhe iu duk sikur midis tyre hyri nga rruga një mori njerëzish, shumë me tepër se ç'ishin grumbulluar para hotelit dhe shtëpisë së kulturës.

Lukrecia e vështroi drejt e në sy dhe u mundua të merrte me mend se ç'kish Josifi, pse u ftoh kaq shpejt me të dhe pse rrinte si mënjanë tavolionës, tamam sikur të ishte ulur aty rastësisht as për një minutë, sa për të thënë vetëm një fjalë.

-Ç'ke, pse s'flet ? - pyeti pas pak Lukrecia duke prishur heshtjen e thellë që kish rënë dhe s'guxoi të ngrejë kokën nga frika se mos lexonte në sytë e tij atë mendim që ai s'guxonte ta thosh me zë. Lukrecia s'e duroi dot më heshtjen e tij dhe ngriti kokën për të parë nëse vërtet gjithçka që kish ndodhur në mes tyre kish qenë një ëndërr e bukur dhe se ajo s'e kish gjetur akoma atë që do të ishte i saj. Në sytë e tij s'pa asgjë, as dashuri, as urrejtje.

Lukrecia u ngrit dhe, ngadalë, si e lodhur, doli nga restoranti, duke e lënë Josifin vetëm, me shishen e verës përpara të pirë deri në gjysmë.

* * *

Kur doli nga restoranti në rrugën e qytetit s'kish asnjëri. Të gjitha dritaret e shtëpive rreth e rrotull s'ndriçonin më. Qyteti kish rënë në gjumë të thellë e të plotë. Sikur nata të mos kish as yje, as hënë njeriu do të pandehte se rreth e rrotull s'ka as jetë. Josifi u tremb nga heshtja e plotë dhe e ftohtë e natës dhe u kthye përsëri në restorant që të pinte dhe ndonjë gotë tjetër, po derën e gjeti të mbyllur. Në sallë s'kish asnjë klient, veç kamarierit i cili po bënte pastrimin e lokalit. Josifi i ra xhamit dhe i bëri shenjë që t'ia hapnin portën, po kamarieri bëri sikur s'e kuptoi.

Josifi u pendua që doli nga restoranti dhe, me që s'kish më ku të shkonte, hyri në hotel. Sportelisti i përgjumur i dha çelësin. Josifi pa orën dhe u çudit se si kish kaluar koha. Duke ngjitur shkallët, vuri re se këmbët s'e mbanin dhe aq mirë, megjithatë, pa e ndjerë nevojën që të mbahej pas parmakëve, u ngjit gjer në katin e tij dhe, duke u munduar të mos bëjë zhurmë, hyri në korridorin e gjatë e të ngushtë.

Kaloi portën e parë, të dytë, të tretë dhe duke ndjerë t'i rrahë zemra, sa më tepër që i afrohej portës së Lukrecias, ngadalëoi hapin, pastaj qëndroi dhe me frikë ktheu kokën. Në krye të shkallëve pa

Në vend të Lukrecias u dëgjua zëri i hotelxhiut pas kuintës që thirri i nervozuar dhe gjithë hall për ardhjen e fajdexhiut koprac që do të mblidhte taksat.

"Ku je moj, lavire, në ç'dhomë je fshehur e bën dashuri me klientët, ë? Për besë, do të ta këpus atë qafë si të zogut nëse nuk do ta bësh atë bir bushtre, atë fajdexhi të qelbur, që të lëpihet pas fustanit tënd. Vetëm ti mund të më shpëtosh. Ku je. po të them!"

"Ja ku jam" - thirri Lukrecia me sa i hante zëri që pas kuintës dhe si i shkeli syrin regjisorit, hyri në skenë duke u përkulur gjithë respekt ndaj të zotit të hanit, pastaj u përkul para publikut, duke i treguar të gjithëve gjinjtë e saj të kërcyer si brumë jashtë jelekut.

"Po kjo ç'bën kështu? - tha me vete regjisori, i cili s'po kuptonte asgjë. Ai, duke ndjekur shfaqjen pas kuintave, u habit me atë mënyrë loje të Lukrecias, e cila po spekullonte me interpretimin e saj, sikur po hakmerrej ndaj qytetit të Peshkopisë e jo të Kopenhagës, që për interesat e disa borxhlinjve s'e kanë për gjë të luajnë dhe me jetën e me nderin e një shërbëtoreje hoteli.

Dhe ashtu luajti, siç deshi, duke ngatërruar dy shekujt, duke përzjerë kopracinë me meskinitetin, duke vënë në lojë me të qeshurën e saj të hidhur e të dhimbshme prapambetjen, injorancën, druajtjen e njerëzve nga opinioni. Dhe njerëzit në sallë, që e dëgjonin, nuk dinin të ndanin rolin e saj nga jeta e saj, nuk kuptonin se hoteli që kishin parasysh në skenë ish në Kopenhagen apo në Peshkopi.

* * *

Pas mbarimit të shfaqjes publiku doli i heshtur nga salla. Asnjë, as regjisorin nuk i folën gjë Lukrecias për atë lloj interpretimi vulgar që i bëri rolit, as për makiazhin që të kujtonte vërtet një lavire. Të gjithë ishin pak a shumë të kënaqur që shfaqja kishte përfunduar pa ndonjë skandal. Të gjithë tok, me Lukrecian në

mes, u nisën nga teatri për në restorant.

Ajo hyri e para duke u munduar të dukej e qetë. Në cep të sallës, në tavolinën pas kollonës, ishte Josifi vetëm. Përpara kishte një shishe vere dhe dy gota bosh.

Ai ndjeu se ata hynë në restorant dhe u ngrit në këmbë, si të ishte një nxënës shkollë që kishte munguar në mësim.

Të gjithë shokët e trupës pritën se çdo të bënte ajo, ku do të shkonte?

Lukrecia, sikur të donte të zbulonte diçka, u nis drejt Josifit që vazhdonte të qëndronte në këmbë. Ajo kishte një dyshim : a kishte qenë Josifi me ta kur u nisën për në shfaqje ?

Ajo s'mbante mend asgjë nga gjithë ç'kishte ndodhur para dy orësh. Dyshonte që ai, Josifi, i cili i qe përgjëruar një natë më parë në shtrat, e kishte braktisur atë çast, qe trembur se mos ndodhte ndonjë skandal dhe se mos e tregonin me gisht : ja ky qe mbrëmë në dhomën e kësaj.

Ajo u bind se ai s'kishte qenë në shfaqje. "Sigurisht as në rrugë, kur dolëm nga hoteli, ai s'ka qenë me mua", mendoi Lukrecia dhe u ul e nevrikosur.

Josifi mori shishen dhe i mbushi asaj gotën. Lukrecia engriti dhe e piu gjysmën. Josifi e ndjeu më tepër gabimin që kish bërë duke mos vajtur në shfaqje dhe u skuq.

-S'ka gjë, - tha Lukrecia, tashmë e bindur që ai nuk e kishte shoqëuar deri te dera e teatrit e nuk kishte qenë në sallë, - mua do të më pëlqente që ti të ishe, sigurisht, jo për të më parë mua, po...

-Më fal, Lukrecia, - tha Josifi dhe përsëri mori shishen e verës.

-Nuk dua më, - tha ajo dhe e tërhoqi gotën, - jam e lodhur dhe e uritur, po të pi do të më zerë.

Josifi e tërhoqi dorën, pa mbaruar ajo fjalën dhe s'guxoi ta vështronte më në sy sepse vështrimi i syve të saj iu duk qortues.

aty mbi gjunjët, siç ishte moda e fustaneve dhe nisi ta ngrrejë lart, duke zbuluar kofshët.

Dhe ajo tjetra, papikë turpi, bëri të njëjtën gjë. Lukrecia sikur u nervozua nga guximi e paturpësia e shëmbëlltyrës dhe, si për ta vënë atë në provë se deri ku do të shkonte guximi, e ngriti dhe më shumë fustanin dhe e hapi fare e, për çudi, në çast, kur kishte mbetur lakuriq para xhamit, me gjinjtë e lëshuar, ndjeu një kënaqësi që nuk e pat provuar kurrën e kurrës në jetën e saj prej njëzet e gjashtë vjetëve. Shëmbëlltyra e saj, që gjithë guxim ishte aq lakuriq sa dhe ajo vetë, e pa sikur të ishte jo ajo, po dikush që përpiqej ta imitonte. Pra ishte një vajzë tjetër, pa ato dy rrudhat e ballit e në cep të syve, ishte një vajzë ku nuk gjeje dot asgjë nga ç'i kishte ndodhur asaj vetë. "Me siguri kjo duhet të jetë e qetë, e gëzuar, e lumtur, s'ka asnjë hall, asnjë problem, nuk i ka ndodhur asgjë në jetë, nuk është braktisur nga i fejuari, as nuk e di fare se ç'është dashuria, thashethemet, opinionin, shpirti i saj duhet të jetë i qetë, ndryshe s'ka se si të shpjegohet gjithë ajo lojë që po bën, që u xhvesh dhe lakuriq".

"Lum si ti", - i pëshpëriti Lukrecia.

Dhe ajo lëvizi buzët aq qartë sa Lukrecia s'e pati vështrirë të kuptonte se dhe ajo tha: "Lum si ti".

Regjisori trokiti në derë e tha:

-Hajde shpejt, Lukrecia, mos u vono!

Lukrecia u tremb e u përmend nga zëri tej derës. Zgjati duart, mori këmishën dhe jelekun e aktit të parë, po nuk u përpoq të vishej shpejt. U vesh me kujdes, shtrëngoi jelekun që t'i nxirrte sa më bukur formën e gjinjve, vuri dhe atë kordele të bardhë në kokë, kapi me karficë një lule delenë kapuç dhe, gjithë kënaqësi, sikur para një çerek ore të mos kishte ndodhur gjë, nisi të lyejë pas shëmbëlltyrën e vet, duke ia zmadhuar paksa sytë, duke tërhequr flokët veshit, pastaj ia mbuloi me krem e pudër rrudhat e ballit e ato nën cep të syve, ia ngjeu buzët me të kuq, duke i trashur që të dukeshin edhe më

epshore, i vuri dy pulla të kuqe në dy faqe, ia nxiu sytë si pus të thellë, ia zbardhi qafën e gushën dhe u kënaq nga transformimi që i bëri, ia shkeli syrin gjithë çapkënllek po jo djallëzore, jo. Dhe ajo tjetra, atje në pasqyrë, sikur të kish pas pritur atë sinjal, shkëljen e syrit lozonjar, u ngrit në këmbë e shkoi te pasqyra e madhe e dollapit dhe e pa me habi vetveten që nga luledeleja në kokë deri te këpuçët me taka, një lloj gallosheje dimri të zografisur me lule e lule gjithë ngjyra sikur, kudo që të vinte ajo këmbën do të mbillte pranverë.

Trokiti dera. Pa u dëgjuar zëri i regjisorit, u dëgjua zëri i shëmbëllesës së saj, një zë i gëzuar :

-Ja, ja! Erdha, gati jam!

Regjisori pas derës puliti sytë. Ai nuk e njoftoi zërin e Zoicës, apo të Lukrecias. Ishte një zë këndues, një zë i lumtur që mezi priste të dilte si ajo kanarina që këndon me sytë në dritare, atje ku kanë çelur mimozat e cërrasin harabelët.

-Zoica, ti je? - u dëgjua zëri i habitur i regjisorit.

-E kush mund të jem tjetër? - u dëgjua pak i habitur e lozonjar zëri i Lukrecias apo i Zoicës, apo i shëmbëllesës, apo zëri i vërtetë i asaj shërbëtoreje hoteli të Kopenhagës, thellë dy shekuj të shkuar që kishte ardhur si me magji që nga veriu i Evropës deri këtu në jug, rëzë malit të Korabit.

-Filloi shfaqja, ke radhën të hysh ti!

-Erdha, erdha! - u dëgjua po ai zë i gëzuar.

Dora e Lukrecias lëvizi bravën .Dera u hap. Regjisori shtangu duke parë fytyrën e saj.

-Ç'ke bërë, Zoica ! Ç'je llangosur kështu ?

-S'jam Zoica, as Lukrecia, - tha dhe ktheu kokën e me që në dhomë nuk e gjeti atë që kërkoi, shëmbëlltyrën e vet që ta ndiqte dhe në skenë, u trishtua.

-Lukrecia, - tha i trembur dhe i habitur regjisori, - a je në gjëndje të lozësh, ë? Mendohu mirë.

sportelistin. Josifi ktheu menjëherë kokën dhe vëzhdoi të ecë në korridorin e gjatë e të ngushtë, deri te dhoma e tij. Duke e hapur, ai ktheu edhe një herë kokën. Sportelisti ishte po në atë vend. Josifi hapi derën e dhomës së tij dhe u fut brenda, u xhvesh pa ndezur dritën dhe ra në shtrat.

Në mëngjes u zgjua nga zhurma e madhe që bëhej në korridor. Iu duk sikur dëgjoji zërin e Lukrecias. U vesh me të shpejtë dhe doli, po në korridor s'pa njeri, as në restorant ai s'gjeti ndonjë nga shokët e trupës. Kur kamarieri i tha se ata kishin ngrënë bukë, Josifi u ngrit. Me të dalë nga restoranti pa autobuzin e vogël të ngarkuar me skenat e shfaqjes. Josifi e njohu telajon që ishte e vendosur në krye, e cila tregonte faqen ballore të dhomës së hotelit. Ngjeshur pas saj vinin njera pas tjetrës pjesët e tjera të telajos. Mbi të gjithë qëndronte lidhur me litarë ajo pjesë e vogël që në skenë formonte atë ballkonin ku pështetej Lukrecia para publikut, i cili me shumë shikonte gjinjte e saj se sa dy vazot e vogla me lule dekorative. Të gjitha ato sende, komiza, perde, në formë dengjesh, karrikesh e kolltukësh me këmbë përpjetë s'ishin gjë tjetër veçse sende të kombinuara, dërrasë, beze, allçi e çikërrima pa vlerë të hedhura e të lidhur për të rezistuar rrugës së gjatë. Gjithë ç'i panë sytë s'ishte gjë tjetër veçse një shkatërrim e përdhunim, një grumbull rraqesh që ishin ngarkuar për t'u hedhur në breg të lumit. dhe njerëzit e grumbulluar rreth e qark autobusit shikonin e nuk u besonin syve për atë mashtrim të madh. Ç'u bë magjia e atij dekori që i montuar në skenë të bënte të besojë vërtet se ishte në një dhomë të një hoteli në Kopenhagë ku kishte jetë, dritë, dashuri, intriga e xhelozit? Josifi mbylli sytë po s'mundi të imagjinojë në komizën e atij ballkoni mbi karroceri atë poezi dehëse, atë atmosferë e ngrohtësi që shpërndante s'andejmi shërbëtorja e hotelit me buzëqeshjen e gjinjte e saj. Mos vallë gjithë ç'kishte parë në skenat e Burrelit, Bulqizës e të Peshkopisë s'ishte gjë tjetër veçse një iluzion siç që dhe vetë me Lukrecia. Mos vallë jetës i jep kuptim, përjetësi

e magji joshëse vetëm arti? Mos vallë dhe Lukrecia që ai puthi buzë shelgjeve të fushës së Vajkalit e përqafoi aq dhimbshurisht në atë shtrat të bardhë të Peshkopisë të ndriçuar nga hëna dhe yjet ishte një iluzion?

Josifi u shqetësua. Mos vallë ai ishte i padenjë për të parë magjinë e skenës mbi karrocerinë e autobusit? Josifi kishte mbetur si i shtangur. Ai mezi u përmend nga një dorë që i rëndoi mbi sup.

-Shpejt, se u vonuam, sot duhet të vemi një çikë herët në Tiranë, se nesër nisemi përsëri për rrugë.

Josifi njohu regjisorin dhe i buzëqeshi. Kur u afruan ata te dera e autobusit, turma e kureshtarëve hapi rrugë.

-Tashti jemi të gjithë, nisu - tha regjisorin.

Josifi pa me habi se pranë Lukrecias ishte i vetmi vend bosh. Ai u ul në çastin kur makina u nis dhe gjer sa autobusi doli nga qyteti, s'guxoi t'i flasë asaj. Edhe të tjerët s'flisnin.

Josifit iu kujtua dita e parë kur hipi në këtë autobus. Dhe atëhere, si tashti, sapo hyri ai, ra heshtja, po atëhere heshtja nuk zgjati shumë. Josifit iu kujtua se si atëhere heshtjen e prishi e qeshura e gjallë dhe e gëzuar e Lukrecias, pastaj ata që të gjithë iu lutën që të luante me letra me ta, pastaj disa ia muarën këngës, pastaj atij iu duk sikur kish vite që jetonte me ta, dhe ndjeu se kurrë në jetë s'kish qenë kaq i lumtur, kurse tashti ndjente në shpirt një peshë të rëndë, që e mundonte, që e mërziste dhe që e bënte nevrrik.

Ai priste çdo sekondë, çdo minutë që dikush të thyehte më në fund këtë heshtje, po kot. Si një sëmundje ngjitesë, heshtja rëndonte nga rreshti në rresht duke shtënë në mendime, në fillim ata që ishin më pranë Lukrecias, pastaj të tjerët. edhe Lukrecia s'kuptonte një gjë: guximin e Josifit që të kthehej bashkë me ta. "Pse s'u nis me autobusin e linjës Peshkopi-Tiranë, kur edhe ai nisej pothuajse në të njëjtën kohë? Apo mos do t'i thotë ndonjë gjë? Po atëhere pse hesht? Ç'pret? Mos vallë pret t'i them se e dashuroj

akoma? Oh! Rënkoj Lukrecia pa e kthyer kokën dhe vazhdoi të flasë me veten e saj: "Gjersa s'u nis me autobusin e linjës, do të thotë se akoma s'ka marrë fund gjithçka. Sigurisht ai mbrëmë s'mund të vinte në dhomën time gjersa unë ika në atë mënyrë nga restoranti, po edhe unë s'mund të rrija më me të kur në sytë e tij s'kish as dashuri, as urrejte. Po të kish në sytë e tij dashuri, unë do të rrija aty, tërë natën dhe tërë ditën tjetër, po të donte ai dhe tërë jetën; edhe po të shihja urrejte në sytë e tij prapë do të rrija aty dhe do t'ia zbusja vështrimin, do ta bëja të qeshte e të më puthte".

Lukrecia ndjeu se si ai lëvizi. Përnjëherësh mendimet e saj ndërprejnë dhe ajo përqëndroi vëmendjen për të ndjerë frymëmarrjen e tij. Nga qetësia e madhe që ishte në autobus asaj iu duk sikur të gjithë e ndjenë se si mori frymë ai.

Regjisori vështrroi nga ata të dy, pastaj pa shokët e trupës dhe, pa dashur ndjeu diçka të rëndë në shpirt, diçka që s'mund ta mposhtëte. S'i kish qëlluar kurrë të bënte me trupën e tij qoftë edhe pesë kilometra udhë me një heshtje të tillë varri. Ai filloi të mos e duronte dot më heshtjen, filloi të bëhej nevrík kur dëgjonte qartë se si shoferi ndërronte marshet, se si buçiste motor i dhe si fërkoheshin rrotat në rrugën e paasfaltuar.

"Në qoftë se ai e do vërtet, nuk ka asnjë kuptim ta torturojë me heshtjen e tij, - nisi të mendojë regjisori. - Sigurisht skandali s'që i pakët, thashethemet qenë të shumta, po fundja, kur njeriu dashuron, s'ka pse të tërhiqet".

Josifi lëvizi përsëri, si për t'iu shmangur vështrimit ngulmues të regjisorit. Pas pak ai lëvizi përsëri sepse ndjeu vështrimin e Shkëlzenit. Josifi e dinte që vetëm ai, Shkëlzeni, e kuptonte, sepse ai e njihje dhe pse me të kish biseduar për Lukrecian. Atij i kish thënë se e dashuronte, se njeriut në jetë rrallë i qëllon të gjejë atë që ka kërkuar, atë që i përshtatet natyrës së tij, atë me të cilën mund të bëjë një jetë të lumtur e të gëzuar, i kish thënë se Lukrecia ishte ajo që

kish ëndërruar, po se jeta e saj s'ishte aq e pastër sa shpirti i saj.

Shkëlzeni; megjithatë e kuptoi se Josifi u shqetësua nga vështrimi i tij, nuk ia ndau sytë. Ai donte të kuptonte dhimbjen e tij, ose diçka tjetër që të-mund të vendoste nëse ai duhej mëshiruar apo urryer. Po Josifi s'e ngriti kokën sepse e dinte, e ndjente që e vështronin të gjithë, sepse që të gjithë donin të dinin rëse ai e kish dashur vërtet Lukrecian, apo ish tallur me të.

Makina u lëkund. Dikush shau shoferin, pastaj përsëri ra heshtja. Lukrecia sikur u zgjua nga lëkundja e makinës. Ajo ngriti kokën dhe ndeshi me vështrimet e shokëve. Ata s'i bënë dot ballë vështrimit të saj, ndërsa Lukrecia, s'guxoi të vështronte Josifin. E pa shkarazi, vetëm një sekondë dhe iu duk tepër i ftohtë dhe i huaj.

Shoferi, kur pa se mbrritën në qendrën e vogël të lokalitetit buzë rrugës, ngadalësoi shpejtësinë dhe foli :

-Si thoni, a pimë nga një kafe ?

-Mirë, - u përgjigj pa qejf regjisorin.

Makina ndaloi. Përrjashta bënte po aq vapë sa pardje. Nga zalli i lumit vazhdonte të ngrihej ai avull që të merr frymën, në cep të hangarëve ishin po ato gra e vajza me ato shamitë e bardha si strehë për t'u mbrojtur nga djegia e diellit dhe pranë tyre po ato kapica me gjethe duhani dhe te dera klubit ishte po ai polic, kapteri i lokalitetit që rrinte kot, o ruante që në atë qendër të vogël të botës të mos ndryshonte asgjë. Të gjithë filluan të zbresin nga autobusi të heshtur, duke vështruar vjedhurazi nga Josifi dhe Lukrecia të cilët s'ishin ngritur akoma. Kur në autobus s'mbeti më asnjë veç Lukrecias, Josifi e ndjeu veten shumë ngushtë. Ai u përpoq të gjente në trurin e tij qoftë dhe një fjalë, po s'gjeti asnjë. Dora e tij u zgjat dhe mori çantën.

-Do të zbresësh këtu ? - pyeti Lukrecia e hutuar.

-Po, - tha Josifi, dhe ndonëse u mundua, prapë s'i erdhi asnjë fjalë në gojë dhe zbriti.

Te dera e autobusit Josifi u mundua sërish. Ai pa vetëm

kokën e Lukrecias që e kishte mbështetur në duart. Kur hipën shokë e saj në autobus ajo i shtrëngoi duart edhe më pas kokës duke zënë veshët sepse iu duk sikur do të dëgjonte pëshpëritjet e shurdhëta të turmës përpara hotelit të Peshkopisë kur prisnin të dilte ajo.

-Mungon kush? -pyeti regjisori dhe pa vendin bosh pranë Lukrecias.

-S'mungon njeri, - foli ajo pa ngritur kokën. - Ai zbriti këtu.

-Nisu, - thirri regjisori kur pa se shoferi nguroi.

Lukrecia ndjeu në zërin e regjisorit një ton të dhimbshëm e të hidhur. Pas pak ajo ngriti kokën dhe pa në dritare, po s'dalloi asgjë. Pluhuri që ngrinte makina kishte mbuluar lokalitetin e vogël, gratë me shami të bardha dhe hangarët e duhanit.

lex 550